

Plani i Përvetësimit të Tokës dhe Restaurimit të Jetesës Gjilan

Kosovë: Projekti i Rrugëve Rajonale – Mbështetja e Njesisë për Zbatimin e Projektit (NjZP)

Klienti

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Titulli i dokumentit

Plani i Përvetësimit të Tokës dhe Restaurimit të Jetesës: Rruga për Qasje në Gjilan

Data e dokumentit

20.06.2022

Rishikimi: 14



iC consulenten Ziviltechniker GesmbH
SchönbrunnerStrasse 297, 1120 Vienna, Austria
T +43 1 521 69-0, F +43 1 521 69-180
office@ic-group.org, www.ic-group.org
FN 137252 t

EN ISO 9001

FLETA KONTROLLUESE E DOKUMENTIT

NUMRI I PROJEKTIT:	Numri i projektit 46x16285
PËRGATITUR NGA:	iC consulenten Ziviltechniker GesmbH Schönbrunner Strasse 297, A-1120 Vienna Tel: +43 1 521 69 0 Fax: +43 1 521 69 180 E-Mail: office@ic-group.org
PËRGATITUR PËR :	Ministria e Infrastrukturës Adresa: Ndërtesa e Odës Ekonomike, Kati i parë, Zyra nr. 2, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës Tel.: +381 (0) 38 200 28 620 E-mail 1: mi.info@rks-gov.net; E-mail 2: Gjynejt.Mustafa@rks-gov.net E-mail 3: Besa.Orana@rks-gov.net
DATA:	01.04.2022
REDAKTOR:	Vaso, Mathews

Data	Nr. i Rishikimit	Redaktor	Kontrolluar nga	Miraturar nga	Nënshkrimi
2017-08-23	0	Fejzić	Mathews	Useini	
2017-08-25	1	Fejzić	Mathews	Useini	
2017-08-28	2	Fejzić/ Begaj	Mathews	Useini	
2017-08-29	3	Fejzić/ Begaj	Mathews	Useini	
2017-08-29	4	Fejzić/ Begaj	Mathews	Useini	
2017-10-16	5	Fejzić	Mathews	Useini	
2017-10-23	6	Fejzić	Mathews	Useini	
2017-11-01	7	Vaso	Mathews	Useini	
2018-11-01	8	Jacimovska	Mathews	Useini	
2018-03-15	9	Jacimovska	Mathews	Useini	
2018-10-04	10	Vaso/ Jacimovska	Mathews	Useini	
2019-05-03	11	Jacimovska	Mathews	Useini	
2021-09-16	12	Vaso	Mathews	Useini	
2022-04-01	13	Vaso	Mathews	Useini	
2022-06-20	14	Vaso	Mathews	Useini	

PËRMBAJTJA

1.	Hyrje	1
1.1.	Objekti dhe Fushëveprimi i Dokumentit	1
1.2.	Përshkrimi i Projektit	1
1.3.	Statusi i aktiviteteve të përvetësimit të tokës	3
1.3.1.	Statusi aktual i përvetësimit të tokës	3
1.3.2.	Procesi i planifikuar i përvetësimit të tokës	4
2.	Korniza Ligjore dhe Institucionale	5
2.1.	Ligji për Shpronësim i Kosovës	5
2.1.1.	Interesi publik.....	5
2.1.2.	Kërkesa për shpronësim	5
2.1.3.	Vendimi preliminar mbi legjitimitetin e shpronësimit të propozuar.....	6
2.1.4.	Vendimi përfundimtar mbi shpronësimin	6
2.1.5.	Kompensimi	6
2.1.6.	Vlerësimi i pronës.....	7
2.1.7.	Data përfundimtare	7
2.1.8.	Konsultimi publik.....	8
2.1.9.	Menaxhimi i ankesave	8
2.2.	Legjislacioni tjetër i ndërlidhur.....	8
2.3.	Kërkesat e BERZH-it	10
2.4.	Korniza Institucionale për Përvetësimin e Tokës në Kosovë	10
2.5.	Analiza e Hendeqeve dhe Mekanizmat e Përafrimit	11
3.	Informatat Bazë	15
3.1.	Regjistrimi i përgjithshëm	15
3.2.	Anketa socio-ekonomike	16
3.3.	Ndikimet e identifikuar	18
3.4.	Personat dhe pronat e prekura	21
3.4.1.	Anëtarët e familjes	21
3.4.2.	Përkatësia etnike	21
3.4.3.	Prodhimi bujqësor	21
3.4.4.	Cenueshmëria	22
3.4.5.	Humbjet e përceptuara.....	22
3.4.6.	Preferencat e kompensimit.....	23
3.4.7.	Bizneset.....	24
4.	Parimet Kryesore të Kompensimit, Përkufizimet dhe Çështjet	26

5.	Kompensimi, të Drejtat dhe Masat e Restaurimit të Jetesës.....	29
5.1.	Përlllogaritja e kompensimit	31
6.	Shpalosja e Informatave dhe Konsultimet Publike.....	32
6.1.	Shpalosja e informatave dhe konsultimet e mbajtura deri më sot	32
6.2.	Mjetet e komunikimit në dispozicion	33
6.3.	Shpalosja e planifikuar e informacioneve dhe konsultimet.....	34
6.3.1.	Dokumentet dhe informacionet që do të shpalosen	34
6.3.2.	Takimet e planifikuara	34
6.3.3.	Orari i takimeve publike.....	35
7.	Zbatimi i PPTRJ-së	35
7.1.	Përgjegjësitë për Zbatim	35
7.2.	Kostot.....	36
7.3.	Monitorimi dhe Raportimi si dhe Monitorimi i Restaurimit të Jetesës	37
8.	Mekanizmi i Ankesave	38

SHTOJCAT

Shtojca 1	Kërkesa për Shpronësim(përkthim kurtoazie)
Shtojca 2	Formulari i ankesës
Shtojca 3	/përpunimin e ankesave
Shtojca 4	Deklarimi i Pronarëve të Bizneseve për Pranimin e Projektit (përfshirë përkthimin e kurtoazisë së tekstit të deklarates)
Shtojca 5	Përlllogaritja për Kompensim

TABELAT

Tabela 1: Legjislacioni në Republikën e Kosovës relevant për zbatimin e projektit	10
Tabela 2: Analiza e hendeqeve relevante për shpronësim dhe mekanizmat e propozuar përafrues/tejkales	17
Tabela 3: Përmbledhja e ndikimeve të projektit lidhur me përvetësimin e tokës nga prona private ...	21
Tabela 4: Përmbledhja e ndikimeve të projektit në lidhje me përvetësimin e tokës nga bizneset formale të anketuara në Komunën e Gjilanit dhe Komunën e Novobërdës	22
Table 5: Përmbledhja e ndikimeve të projektit në lidhje me përvetësimin e tokës nga bizneset joformale të anketuara në Komunën e Gjilanit dhe Komunën e Novobërdës.....	23
Table 6: Tabela përmbledhëse e humbjeve të perceptuara	26
Table 7: Përmbledhja e ndikimeve të ndërlidhura me projektin në bizneset e prekura	27
Table 8: Masat lehtësuese që do të zbatohen gjatë fazës së ndërtimit në parcelat e përzgjedhura ..	29
Table 9: Matrica e të drejtave	34
Table 10: Përgjegjësitë implementuese të PPTRJ-së	39
Table 11: Përlllogaritja e kostove të kompensimit për kategorinë e humbjeve të përhershme të bizneseve	49
Table 12: Përlllogaritja e kostove të kompensimit për kategorinë e humbjeve eventuale të përkohshme të bizneseve	58

FIGURAT

Figure 1: Harta e Rrugëve të Republikës së Kosovës (Burimi: Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës)	2
--	---

1. HYRJE

1.1. OBJEKTIVI DHE FUSHËVEPRIMI I DOKUMENTIT

Ky dokument është Plani i Përvetësimit të Tokës dhe Restaurimit të Jetesës (PPTRJ) për Projektin e Rrugëve Rajonale të Kosovës që zbatohet nga Ministria e Infrastrukturës e Kosovës, për seksionin e Projektit **N25.2 Rruga për qasje në Gjilan**. Ai është përgatitur në përputhje me ligjet e Kosovës, si dhe me kërkesat e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Politikën Mjedisore dhe Sociale 2014¹ dhe Kërkesat e saj të Performancës (KP), veçanërisht KP 5: Përvetësimi i Tokës, Risistemimi Jovullnetar dhe Zhvendosja Ekonomike. Dy Plane të Përvetësimit të Tokës (PPT) të hollësishme e të veçanta për seksionet e rrugëve të Prizrenit dhe Klllokot-Gjilanit dhe një PPTRJ për seksionin e rrugës së Ferizajt janë përgatitur në kuadër të këtij Projekti.

PPTRJ përcakton procedurat që duhet të ndiqen nga Qeveria e Kosovës përmes Ministrisë së saj të Infrastrukturës (MI), si dhe veprimet që do t'i ndërmarren për kompensimin e duhur të personave të prekur. Dokumenti ofron një përshkrim të tokës, ekonomive familjare dhe bizneseve që do të ndikohen nga përvetësimi i pronës në Komunën e Gjilanit dhe në Komunën e Novobërdës. Qëllimi i këtij PPTRJ është që t'i përcaktojë dhe zvogëlojë ndikimet negative të përvetësimit të tokës dhe kufizimet në përdorimin dhe qasjen në tokën nga personat e prekur, si dhe të përcaktojë të drejtat e kategorive të ndryshme të personave të prekur, duke i kushtuar vëmendje të veçantë atyre më të cenueshëm.

PPTRJ zbatohet për të gjithë personat e prekur, pavarësisht numrit të përgjithshëm të personave të prekur dhe pavarësisht nëse janë titullarë të regjistruar ligjërisht të tokës. Sidoqoftë, shkalla e ndikimit do të ndikojë në natyrën e kompensimit dhe ndihmës tjetër të ofruar.

Ky dokument PPTRJ është rezultat i konsultimeve, grumbullimit të të dhënave dhe analizave të bëra nga Konsulenti, iC consulenten, dhe përfshin masa për të mbrojtur jetesën e personave të prekur. PPTRJ është përgatitur në bazë të Kornizës për Përvetësim të Tokës (KPT), e cila është hartuar në vitin 2015 si pjesë e projektit të vigjilencës së duhur “Kosovë – Rrugët Rajonale dhe Lokale – Vlerësimi Mjedisor dhe Social”, i cili është kryer nga Enova, Consultants and Engineers, në Sarajevë.

Kërkesat e këtij PPTRJ janë detyruese si për Qeverinë e Kosovës, përmes MI-së, ashtu dhe për Kontraktuesit që do të punësohen për të marrë përsipër ndërtimin dhe funksionimin e Projektit.

1.2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) është duke shqyrtuar ofrimin e financimit MI-së në mbështetje të punëve për përmirësimin e rrugëve nacionale në kuadër të Projektit të Rrugëve Rajonale të Kosovës (Projekti). Projekti përfshin zgjerimin në katër korsi të rrugëve hyrëse/dalëse në Komunitet e Gjilanit, Ferizajt dhe Prizrenit dhe rehabilitimin e seksionit të rrugës Klllokot – Gjilan. Këto seksione konsiderohen projekte me prioritet në kuadër të *Strategjisë të Transportit Multimodal (2012-2021)* dhe *Planit të Veprimave (2012-2016)* të Kosovës. Vigjilenca e duhur për projektin është përfunduar në vitin 2015 dhe është krijuar Korniza për Përvetësim të Tokës (KPT) për seksionet e Projektit duke përdorur informacionin që në atë kohë ishte në dispozicion të Konsulentit².

¹ Teksti i plotë i PMS BERZH është në dispozicion në: <http://www.ebrd.com/news/publications/policies/environmentaland-social-policy-esp.html>

² KPT është në dispozicion në: http://mi-ks.net/repository/docs/2016_02_15_081438_Kosovo_Roads_LAF_final_8_Dec_2.pdf

Dy PPT të veçanta e të hollësishme për seksionet e rrugëve të Prizrenit dhe Kllokot-Gjilanit dhe një PPTRJ për seksionin e rrugës së Ferizajt janë përgatitur për seksionet e Projektit. Seksioni N25.2 i rrugës për qasje në Gjilan është rruga kryesore e hyrjes në komunën e Gjilanit nga drejtimi i kryeqytetit të vendit, Prishtinës dhe lidhja më e shpejtë me autostradën A1 në Republikën e Serbisë. Ky seksion është degë e rrjetit kryesor kombëtar dhe rajonal të rrugëve të Kosovës, dhe rrjedhimisht është nën juridiksionin e MMPHI-së (Figura 1).



Figura 1: Harta e Rrugëve të Republikës së Kosovës (Burimi: Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës)

Gjatësia e rrugës për qasje do të jetë 2,900 m dhe do të përfshijë katër rrethrotullime dhe infrastrukturën në vijim: energjinë elektrike, sistemin e kanalizimeve, sistemin e kullimit të tejprurjeve, shenjat e trafikut dhe ndriçimin.

Projektimi i karrexhatës dhe trotuarit: Rrugë me karrexhatë të dyfishtë me nga dy korsi. Gjerësia e rrugës është 19 m (2 korsi për çdo drejtim - gjithsej 4 korsi x 3.5 m, të ndara nga një ishull i gjerë prej 2.0 m). Të dyja anët kanë trotuar për këmbësorë (2 x 1.5 m). Ky seksion shtrihet përgjatë zonës periferike të komunës së Gjilanit. Përgjatë anëve të rrugës ka shtëpi individuale, ndërtesa tregtare dhe gjashtë stacione të benzinës. Toka në afërsi të rrugës e paraparë për zgjerim përdoret pjesërisht për qëllime biznesi. Kjo hapësirë është e rezervuar nga komuna për zgjerim të rrugëve, prandaj ndikimet do të jenë të kufizuara në strukturat dhe aktivitetet tregtare jobujqësore (siç përcaktohet në Seksionin 3.3 të këtij dokumenti). Pritet që gjithsej **169 persona do të preken**³ nga marrja e tokës dhe/ose strukturës si rezultat i zbatimit të Projektit. Korniza për Përvetësim të Tokës (Dhjetor, 2015) përcaktoi cënueshmërinë për të gjithë projektin e rrugëve rajonale përfshirë personat e prekshëm / familjet, të tilla si nënat e vetme, të vejat dhe burrat e vejë, personat me aftësi të kufizuara ose ata që jetojnë në varfëri të skajshme. Në kuadër të projektit të vigjilencës së duhur nuk është regjistruar asnjë grup i veçantë i cenuar gjatë vizitave në terren të zhvilluara në vitin 2015, gjë që u konfirmua në regjistrimin e qershorit të vitit 2017. Gjithashtu, nuk është evidentuar/regjistruar asnjë strukturë e trashëgimisë kulturore si në vitin 2015, gjë që u konfirmua në vitin 2017. Përgjatë rrugëve nuk ka institucione që shoqërohen me trafik të rëndë të këmbësorëve të tilla si shkolla, spitale, etj.

1.3. STATUSI I AKTIVITETEVE TË PËRVETËSIMIT TË TOKËS

1.3.1. Statusi aktual i përvetësimit të tokës

MI, si parashtrues i kërkesës e ka dërguar kërkesën për Shpronësim (Referenca: 4632/2017, datë 02 qershor 2017) në Zyrën e Shpronësimit të MMPH, duke iniciuar kështu zyrtarisht procedurën e shpronësimit në përputhje me legjislacionin kombëtar (ju lutem shihni Kapitullin 2 të këtij dokumenti për përshkrimin e procedurës), pas komisionimit dhe kompletimit të Elaboratit të Shpronësimit për zgjerimin e rrugës nacionale N25.2: Hyrja në qytetin e Gjilanit (Vizion Project, shkurt 2017). Nga jo kohë, azhurnime të elaboratit të shpronësimit janë bërë në muajin nëntor 2018 dhe gusht 2021.

Bazuar në të dhënat e ofruara nga Ministria e Infrastrukturës, MMPH ka pranuar kërkesën gjatë muajit dhjetor 2017 (Vendimi nr.13/21, i datës 22.12.2017), të dorëzuar nga MI më herët. Kërkesa për Shpronësim ishte ndryshuar me Vendimin Nr.09/11 të datës 07.05.2021. Afati ligjor sipas Ligjit për Shpronësim të Kosovës ishte 15 ditë pas marrjes së kërkesës, përkatësisht Kërkesës për Shpronësim (Shtojca 1 e këtij dokumenti). Megjithatë, procesi i shpronësimit është ende në një fazë të hershme pasi që Ministria e Financave dhe Zyra e saj për Pronën e Paluajtshme ende mbetet të përcaktojë shumën e kompensimit për secilin grup të prekur. Përveç kësaj, ky dokument siguron masa për restaurimin e jetesës për pronarët dhe punëtorët e prekur të biznesit, si dhe llojet e kompensimit dhe parimet e llogaritjes.

Domethënë, zona e parcelave që do të preken është definuar në Elaborat dhe të gjitha ndikimet e projektit në lidhje me shpronësimin e tokës janë përcaktuar. Qeveria e

³ Përveç identifikimit të parë të 74 personave të prekur në Komunën e Gjilanit, 81 persona të tjerë nga komuna e Novobërdës do të preken në bazë të informacionit nga Elaborati i ri i Shpronësimit për një pjesë të seksionit rrugor që ndodhet në Komunën e Novobërdës. Gjithashtu, 8 parcela publike do të preken në territorin e Novobërdës. Në një fazë të mëvonshme, 3 PAP të tjerë nga Komuna e Novobërdës u identifikuan se do të preken nga marrja e tokës për shkak të ndryshimeve më të reja të projektit në vitin 2019. Në sajë të anketimit të fundit të zhvilluar nga Konsulenti gjatë periudhës gusht-shtator 2021, për të plotësuar zbrazëtitrat në elaboratin e mëparshëm të shpronësimit, janë identifikuar edhe 11 PAP të ri/shtesë. Në anketimin e fundit është identifikuar edhe një stacion shtesë karburanti që është ndërtuar pas datës së përfundimit në parcelën nr 4017/4. Konsulenti, megjithëse ka identifikuar ndikimin në strukturë, nuk ka llogaritur personat e prekur si PAP, pasi që kjo është jashtë fushëveprimi të projektit të BERZH-it.

Kosovës ka njoftuar bartësit e identifikuar të drejtave pronësore. Vendimi nr.13/21⁴ mbi miratimin u publikua në Gazetën Zyrtare dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë, i cili publikim përsëritet pas 7 deri në 10 ditë, pasuar me një periudhë 10-ditore gjatë së cilës palët e interesuara kanë të drejtë të dorëzojnë komente me shkrim tek organi shpronësues. Pas publikimit, nga autoriteti shpronësues është kërkuar të mbajë një dëgjim publik brenda 15 ditëve në secilën komunë përkatëse ku ndodhen pronat që i nënshtrohen shpronësimit, gjë e cila është realizuar gjatë muajit janar 2018. Për informacione më të hollësishme mbi konsultimet publike të mbajtura, ju lutemi referojuni Kapitullit 6.1.

Në komunën e Gjilanit pritet që gjithsej 48 parcela private do të preken nga marrja e tokës, me një total prej 4,714.5 m², siç përcaktohet në Elaboratin e Shpronësimit.

Parcelat në komunën e Novobërdës janë shpronësuar në vitin 1974 me qëllim të zgjerimit të seksionit të kësaj rruge (me një total prej 12,008.0 m² bazuar në të dhënat e vjetra kadastrale). Më 8 shkurt 2017, NjZP i dërgoi një letër Komunës së Novobërdës përmes së cilës kërkoi që të procedohet me transferimin e 45 parcelave kadastrale Qeverisë së Kosovës - Ministrisë së Infrastrukturës, të cilat do të ndikohen nga projekti rrugor i financuar nga BERZH. Gjithashtu, NjZP ka organizuar takime me përfaqësuesit e komunave me qëllim për të trajtuar këtë çështje. Më 12 tetor 2017, NjZP ka dërguar një kërkesë për mbështetje në Agjencinë Kadastrale të Kosovës për të finalizuar këtë transferim. Në muajin dhjetor 2017 ndryshimet janë pasqyruar në regjistrin kadastral dhe transferimi i pronësisë për këtë pjesë të rrugës është finalizuar. Elaborati i Shpronësimit për pjesën e segmentit rrugor që ndodhet në Komunën e Novobërdës, zona kadastrale Koretishhtë (dhjetor 2017) është përdorur për të përditësuar këtë PPTRJ. Bazuar në këtë dokumentacion, gjithsej 89 parcela do të ndikohen nga seksioni rrugor në Novobërdë, nga të cilat 81 janë pronarë privatë dhe 8 parcela janë tokë publike. Gjithsej toka që do të merret është 18,099 m² për Komunën e Novobërdës.

Gjatë periudhës janar-maj 2019 është bërë ndryshimi i dizajnit të projektit për të përfshirë modifikimet e rrethrotullimit në hyrje të Gjilanit. Për shkak të ndryshimit të përmendur do të kërkohet përvetësim shtesë i tokës prej 628 m², prandaj sipërfaqja e përgjithshme e marrjes së tokës në këtë seksion rrugor është 18,727 m².

Fillimisht, i gjithë procesi është iniciuar vetëm për pronarët formal/përdoruesit formal të tokave pasi që legjislacioni i Kosovës nuk i njeh përdoruesit/shfrytëzuesit joformal të tokës (ju lutem shihni Seksionin 2.5 të këtij dokumenti për përshkrimin e boshllëqeve ndërmjet legjislacionit të Kosovës dhe kërkesave të BERZH-it).

Elaborati i Shpronësimit është ndryshuar me vendimin 9/11 të datës 07.05.2021 në mënyrë që të përfshijë informacionet për përdoruesit/shfrytëzuesit joformal, humbjen e mjeteve të jetesës si dhe përvetësimin shtesë të tokës për shkak të ndryshimit të dizajnit të rrethrotullimit në hyrje të Gjilanit, dhe është dorëzuar sërish në Zyrën e Pronës së Paluajtshme.

1.3.2. Procesi i planifikuar i përvetësimit të tokës

Sipas procedurës së përcaktuar në legjislacionin kombëtar, MMPH-së i kërkohej që të jetë në kontakt me Agjencinë Kadastrale të Kosovës (AKK-në) për të siguruar që informacioni i paraqitur në Elaboratin e Shpronësimit është i përditësuar dhe i saktë. Pasi që ishte konfirmuar se Elaborati i Shpronësimit është i saktë, MMPH ka miratuar Vendimin nr. 13/21 të datës 22.12.2017, për pranimin e kërkesës për përpunim të mëtejshëm dhe ka dërguar një kopje të kërkesës dhe dokumenteve shoqëruese në Zyrën e Vlerësimit të Pronës së Paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave (MF) për vlerësimin e

⁴ Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=15826>

pronave të prekura. Kërkesa për Shpronësim ishte ndryshuar me Vendimin nr.09/11, të datës 07.05.2021.

Elaborati i Shpronësimit është duke u mbajtur aktualisht në Ministrinë e Financave, përkatësisht në Zyrën e Pronës së Paluajtshme në kuadër të Departamentit të Tatimit në Pronë, në pritje të procedurës administrative të përcaktuar në Ligjin e Kosovës për Shpronësim (ju lutem shihni seksionin 2.4). Duke pasur parasysh se dokumentet lokale të shpronësimit mbulojnë vetëm përdoruesit formal dhe ky dokument ka identifikuar edhe përdoruesit joformal, dokumenti i shpronësimit të tokës duhej rishikuar për të përfshirë të gjitha parcelat e prekura të tokës dhe përdoruesit e tokës pavarësisht nga statusi i tyre i formalitetit. MMPHI do të azhurnojë dokumentet e shpronësimit të tokës me ndihmën e ekspertëve të jashtëm. Duhet të dorëzohet një amendamentim zyrtar i dokumentacionit (Letra) që kërkon kompensimin e kategorive ii dhe iii të PPP-ve (e shpjeguar më poshtë) në lidhje me Marrëveshjen e Huasë ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe BERZH-it. Letra, së bashku me Elaboratin e azhurnuar të Shpronësimit duhet të dorëzohet nga MI (përfituesi i shpronësimit) tek MMPHI (autoriteti i shpronësimit) dhe MF (vlerësimi dhe përlllogaritja e kompensimit). Pas azhurnimit të Elaboratit të Shpronësimit, Vendimi Preliminar për Shpronësim do të mbulojë të gjitha 3 kategoritë e PPP-ve: (i) pronarët formal të tokës dhe strukturave, (ii) përdoruesit joformal të tokës, pa të drejtë mbi tokën (toka në pronësi të shtetit), por me të drejta mbi strukturat, dhe (iii) pronarët e bizneseve dhe punonjësit e bizneseve të vendosura në strukturat që u përkasin përdoruesve formal dhe joformal.

Elaborati i Shpronësimit është azhurnuar gjithashtu për të pasqyruar marrjen e tokës shtesë për shkak të ndryshimit të dizajnit të rrethrotullimit në hyrje të Gjilanit dhe rrethrotullimit të Pasjakut, dhe është dorëzuar sërish në Zyrën e Pronës së Paluajtshme. Ende nuk një afat kohor të përcaktuar për procesin në pritje të përvetësimit të tokës. Sipas nenit 16 të Ligjit për Shpronësim, *“Shuma e kompensimit të shpronësimit e përcaktuar në vendimin përfundimtar do të paguhet plotësisht brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit”*. Sipas përvojës së NjZP-së nga projekte të ngjashme, kohëzgjatja e parashikuar e gjithë procedurës së shpronësimit zgjat përafërsisht 2 - 3 vjet.

2. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE

2.1. LIGJI PËR SHPRONËSIM I KOSOVËS

Procedura e shpronësimit të tokës dhe risistemimit/rivendosjes në Kosovë rregullohet në radhë të parë me *Ligjin Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra në Ligjin Nr. 03/L-205 të datës 28 tetor 2010* (Ligji për Shpronësim i Kosovës). Ligji përshkruan procedurën, duke përfshirë mjetet juridike, për të mbrojtur individët nga ndërhyrjet joproporcionale në të drejtën e pronës së paluajtshme⁵. Dispozitat kryesore të këtij Ligji janë përmbledhur më poshtë.

2.1.1. Interesi publik

Shpronësimi mund të kryhet vetëm kur të plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme (Neni 4):

- i. shpronësimi bëhet në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë për arritjen e një qëllimi të ligjshëm publik;
- ii. qëllimi i ligjshëm publik nuk mund të arrihet në mënyrë praktike pa kryerjen e shpronësimit;

⁵ Sipas ligjit, prona e paluajtshme përfshinë: (i) tokën, (ii) ndërtesat ose pjesët e veçanta të një ndërtese të ndërtuara në, mbi ose nën sipërfaqen e tokës si dhe (iii) pjesët përbërëse dhe sendet aksesore të cilat i janë bashkuar tokës ose ndërtesës në bazë të përhershme dhe të cilat nuk mund të largohen pa përpjekje të paarsyeshme ose jo-ekonomike, dhe (iv) frutat e pashkëputura nga toka e tillë.

- iii. përfitimi publik nga shpronësimi është më i madh se interesat të cilat do të ndikohen negativisht nga shpronësimi;
- iv. prona e paluajtshme e cila është objekt i shpronësimit nuk është zgjedhur për arritjen e një qëllimi ose synimi diskriminues; dhe,
- v. organi shpronësues i ka përmbushur të gjitha dispozitat e aplikueshme të këtij ligji.

2.1.2. Kërkesa për Shpronësim

Fillimi i procedurës së shpronësimit kryhet nga vetë Organi Shpronësues (MMPHI) ose përmes një kërkesë për shpronësim të dorëzuar në organin shpronësues (neni 7). Kërkesa përmban informacionin e nevojshëm mbi bartësit e të drejtës pronësore dhe pronat e prekura, përshkrimin e të gjitha të drejtave që kanë të bëjnë me një parcelë, përshkrimin e hollësishëm të qëllimit publik për të cilin kërkohet shpronësimi, të shoqëruar me dokumente që përfshijnë të dhënat e pronësisë, planet kadastrale, hapësinore ose urbanistike dhe dëshmi se ka ose do të ketë mjete të mjaftueshme financiare në dispozicion për pagesën në kohë të kompensimit.

Pas pranimit të kërkesës, organi shpronësues e shqyrton kërkesën dhe mund ta miratojë ose refuzojë kërkesën, tërësisht ose pjesërisht.

Në rast miratimi, autoriteti shpronësues dërgon një kopje të kërkesës dhe të gjitha dokumentet e bashkangjitura në Zyrën për Vlerësimin e Pasurisë së Paluajtshme dhe i njofton bartësit e identifikuar të të drejtave të pronësisë. Vendimi për miratim publikohet në Gazetën Zyrtare dhe në një gazetë të përditshme në Kosovë që gëzon një qarkullim të gjerë, i cili publikim përsëritet pas 7 deri në 10 ditë, pasuar me një periudhë 10-ditore gjatë së cilës palët e interesuara kanë të drejtë t'i paraqesin komente me shkrim autoritetit shpronësues. Pas publikimit, autoritetit shpronësues i kërkohet të mbajë një dëgjim publik brenda 15 ditëve në secilën komunë ku ndodhen pronat që i nënshtrohen shpronësimit.

2.1.3. Vendimi preliminar mbi legjitimitetin e shpronësimit të propozuar

Pas shqyrtimit të komenteve me shkrim dhe shqetësimeve të shprehura në dëgjimet publike, organi shpronësues miraton një Vendim Preliminar brenda 30 ditëve (neni 10). Organi mund të refuzojë shpronësimin bazuar në këto komente dhe shqetësime, ose në rast se përcakton që shpronësimi i propozuar nuk i plotëson kërkesat ligjore. Vendimi preliminar publikohet në Gazetën Zyrtare të Kosovës dhe në gazetatat ditore.

2.1.4. Vendimi përfundimtar mbi shpronësimin

Organi shpronësues miraton Vendimin Përfundimtar duke e aprovuar ose refuzuar kërkesën gjatë një periudhe 12-mujore pas hyrjes në fuqi të Vendimit Preliminar (neni 11). Vendimi përfundimtar publikohet në Gazetën Zyrtare të Kosovës dhe në gazetatat ditore. Vendimi përfundimtar nuk mund të miratohet në rast se ndonjë ankesë kundër vendimit preliminar lidhur me pronat e prekura ende është në pritje në gjykatë. Nëse kërkesa mbulon më shumë se një parcelë të pronës, organi shpronësues mund të lëshojë një ose më shumë vendime përfundimtare, ku secili nga këto vendime përfundimtare mbulon një ose më shumë parcela në fjalë.

2.1.5. Kompensimi

Kompensimi rregullohet me Ligjin për Shpronësim të Kosovës si dhe me *Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2015 për Miratimin e Metodave dhe Kritereve Teknike të Vlerësimit për Llogaritjen e Shumës së Kompensimit për Pronën e Paluajtshme që Shpronësohet dhe Dëmeve që kanë të bëjnë me Shpronësimin*, të miratuar në vitin 2015 nga Ministria e Financave në bazë të Ligjit. Sipas Ligjit, kompensimi bëhet në bazë të vlerës së tregut të

pronës⁶, duke përfshirë pjesët aksesore dhe frutat e saj, plus *çdo dëmtim të dukshëm të drejtpërdrejtë të shkaktuar për shkak të shpronësimit*. Kompensimi paguhet në mjete monetare⁷, dhe përfshin shumën e përcaktuar në Vendimin Përfundimtar plus interesin në shumën e tillë që është grumbulluar në mes të datës së hyrjes në fuqi të vendimit përfundimtar dhe datës së pagesës.

Asnjë ndryshim në pronësi ose të drejta të tjera të personave të prekur nuk hyn në fuqi ose zbatohet derisa të hyjë në fuqi vendimi përfundimtar dhe të jetë paguar kompensimi i kërkuar nga vendimi përfundimtar. Vetëm pasi të jenë plotësuar kushtet e përmendura, prona regjistrohet në emër të Qeverisë së Kosovës.

2.1.6. Vlerësimi i pronës

Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme është përgjegjëse për vlerësimin e pronës në proces të shpronësimit (neni 21 dhe neni 22), në bazë të *Udhëzimit Administrativ* të lartpërmendur, i cili rregullon metodologjinë e hollësishme për llogaritjen e kompensimit që duhet paguar për pronat e shpronësuara dhe dëmet e ndërlidhura me shpronësimet⁸. Një nga metodat e mëposhtme ose metodat e kombinuara të vlerësimit të pronës mund të përzgjidhen gjatë vlerësimit të pronës së paluajtshme:

- metoda e shitjeve krahasuese,
- metoda e kostos, dhe
- metoda e të ardhurave.

Vlera e pronës që konsiderohet si tokë bujqësore merr parasysh cilësinë e tokës, afërsinë me vendbanimin, qasjen në infrastrukturë, madhësinë dhe formën e parcelës, sistemin e ujitjes ose potencialin e ujitjes, si dhe kushtet e tjera mjedisore që lidhen me karakteristikat fizike të terrenit (lartësia dhe pjerrësia). Vlera e tokave pyjore dhe pyjeve përcaktohet duke marrë parasysh cilësinë e tokës, vlerën mjedisore të tokës, vendndodhjen gjeografike, sasinë dhe cilësinë e biomasës, nivelin e investimeve dhe qasjen në infrastrukturë, kushtet e transportit dhe kushtet mjedisore. Vlerësimi i zonave të banuara dhe të tjera të ndërtuara merr parasysh kriteret siç janë: lloji i ndërtësës, materiali ndërtimor, sipërfaqja në m² për strukturat banesore dhe jo-banesore, viti i ndërtimit, qasja në rrugë, qasja në shërbimet publike, sistemi i ngrohjes, gjendja e objektit, marrjen me qira dhe kushtet e qirasë, kosto e operimit dhe mirëmbajtjes, etj. Gjatë procesit të vlerësimit, pronarët dhe zotëruesit e interesave kanë të drejtë të paraqesin pikëpamjet e tyre me shkrim në Zyrën respektive, në lidhje me vlerësimin e tillë dhe të kundërshtojnë vendimet e vlerësimit përfundimtar të Zyrës në gjykata.

2.1.7. Data përfundimtare

Ligji për Shpronësim i Kosovës (neni 7) përcakton datën përfundimtare me vendimin e pranimit⁹ të kërkesës për shpronësim dhe publikimit të vendimit në Gazetën Zyrtare të Kosovës dhe në ndonjë gazetë që gëzon qarkullim të gjerë në Kosovë.

Ligji për Shpronësim i Kosovës në mënyrë specifike parashikon që do të përjashtohen nga shumat e kompensimit si vijon:

- kosto ose vlera e çfarëdo përmirësimi të pronës, objekteve të ndërtuara ose të zgjeruara në pronë, ose pemët apo bimët e mbjella në pronë pas datës së

⁶ Vlera e tregut përkufizohet si: "çmimi që blerësi është i gatshëm të paguajë dhe shitësi të shes pronën e paluajtshme në një transaksion zyrtar, kur asnjëri nuk është i detyruar të veprojë me forcë dhe nuk ka marrëdhënie ndërmjet palëve në bazë të gjakut, martesës, pronësisë të përbashkët ose lidhjeje biznesi".

⁷ Kompensimi në natyrë sipas mënyrës tokë për tokë (ose një kombinim në natyrë dhe në para të gatshme) sigurohet ekskluzivisht në rastet kur Qeveria është organi shpronësues dhe më shumë se 20 parcela të pronës së paluajtshme shpronësohen, nëse pronarët e pronave të tilla janë dakord.

⁸ Ligji për Shpronësim thotë se "Kompensimi përfshin kompensimin e çdo dëmi të drejtpërdrejtë i cili mund të dëshmohet, i cili i shkaktohet personit të shpronësuar si pasojë e shpronësimit plus vlerën e pronës së paluajtshme të shpronësuar, duke përfshirë – nëse është e aplikueshme - pjesët aksesore dhe frutat e saj"

⁹ Vendimi i Kryeministrit është ende i hapur dhe ende pritet që të publikohet për shkak të përditësimeve shtesë të shpronësimit të pjesshëm.

publikimit në Gazetën Zyrtare të vendimit të pranimit të kërkesës për shqyrtim të mëtutjeshëm të shpronësimit (lëshuar para vendimit preliminar),

- çfarëdo ndryshimi në vlerën e tregut të pronës që ka ndodhur qoftë pas datës së miratimit të vendimit për autorizimin e kryerjes së punëve përgatitore në pronën e tillë, ose datës së paraqitjes fillestare të kërkesës për shpronësim cilado që paraqitet më herët,
- çfarëdo ndryshimi në vlerën e tregut të pronës së paluajtshme i cili ndodh para fillimit të procedurës së shpronësimit, nëse ky ndryshim mund të dëshmohet se ka ardhur si rezultat i manipulimit të çmimit ose tregut ose spekulimeve nga personat (ose të afërmit apo bashkëpunëtorët e tyre) që kanë pasur informata mbi shpronësimin e pritshëm ose të mundshëm të pronës përkatëse.

2.1.8. Konsultimi publik

Ligji për Shpronësim i Kosovës u siguron personave të prekur mekanizmat ligjor të konsultimit publik (neni 9), pas publikimit të Vendimit të Pranimit të kërkesës për shpronësim në media, kur çdo palë e interesuar ka të drejtë të paraqes tek organi shpronësues komentet me shkrim mbi shpronësimin në fjalë. Pas kësaj, organi shpronësues organizon një dëgjim publik në Komunën ku do të bëhet shpronësimi. Personat të cilët dëshirojnë të marrin pjesë në këto dëgjime publike duhet të ofrojnë dëshmi se janë zyrtarë publikë të Komunës aty ku zhvillohet dëgjimi publik, ose ndonjë pronar ose zotërues interesi në lidhje me pronën në fjalë që gjendet në atë Komunë ku zhvillohet dëgjimi publik, ose avokat i ligjshëm ose përfaqësues i një zyrtari të tillë publik, pronari ose zotëruesi të interesit.

2.1.9. Menaxhimi i ankesave

Ankesat e përcaktuara me Ligjin për Shpronësim të Kosovës përfshijnë: (i) ankesat që kundërshtojnë vendimin preliminar për legjitimitetin e shpronësimit të propozuar, (ii) ankesat që kundërshtojnë përshtatshmërinë e kompensimit, (iii) ankesat për kompensimin e dëmeve që rrjedhin nga shpronësimi i pjesshëm; (iv) ankesat që kundërshtojnë legjitimitetin e vendimit për shfrytëzimin e përkohshëm të pronës.

2.2. LEGJISLACIONI TJETËR I NDËRLIDHUR

Legjislacioni tjetër në Kosovë i rëndësishëm për zbatimin e projektit është përmbledhur në Tabelën 1.

Ligji	Përmbledhje dhe pikat kryesore
Kushtetuta e Republikës së Kosovës	Kushtetuta ndalon privimin arbitrar të pronës (neni 46) - autoriteti mund të bëjë shpronësimin e pronës nëse ky shpronësim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dheadekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet.
Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore nr.03/L-154 i datës 15 korrik 2009	Ky ligj rregullon krijimin, përmbajtjen, bartjen, mbrojtjen si dhe shuarjen e të drejtave sendore siç janë pronësia, të drejtat sendore të kufizuara, posedimin të drejtat sendore të sigurimit si dhe të drejtat sendore të shfrytëzimit. Parasheh që pronësia dhe të drejtat sendore të tjera mund të kufizohen ose të merren kundër vullnetit të titullarit vetëm sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara me ligjet e aplikueshme.

Ligji	Përmbledhje dhe pikat kryesore
Ligji për Kadastër Nr. 04/L-013 i datës 12 gusht 2011	Rregullon kadastrin e palujtshmërive, matjet shtetërore dhe kadastrale, punët gjeodezike dhe kadastrale si dhe përfitimin, regjistrimin, ruajtjen, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e të dhënave kadastrale.
Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2002/5 për themelimin e regjistrit të të drejtave të pronës së paluajtshme	Përcakton parimet e zbatimit dhe validimit të të drejtave të pronës së paluajtshme në Kosovë përmes mekanizmit të Regjistrit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme. Të drejtat e pronës së paluajtshme, duke përfshirë (i) pronësinë, (ii) hipotekat, (iii) servitutët, (iv) të drejtat e përdorimit të pronës komunale, publike, sociale dhe shtetërore dhe (v) ngarkesat e pronës regjistrohen në Regjistër. Përcakton autoritetin mbi administrimin e përgjithshëm të Regjistrit në Agjencinë Kadastrale të Kosovës (AKK) dhe cakton Zyrat Kadastrale Komunale (ZKK) për të regjistruar, me shkrim, të drejtat e pronës së paluajtshme në Regjistër nën autoritetin e AKK-së.
Ligji për Procedurën Administrative nr. 02/L-28 i datës 22 korrik 2005	Përcakton parimet që do të zbatohen nga të gjitha organet e administratës publike gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre nëpërmjet akteve individuale dhe kolektive. Organet e administratës publike, në ushtrim të veprimtarisë administrative, duhet të vendosin një balancim të drejtë mes interesave publike dhe interesave private të përfshira në të, në mënyrë që të evitohen ndërhyrjet e panevojshme në të drejtat dhe interesat e personave fizik dhe juridik. Organet e administratës publike nuk lejohet të bëjnë dallime lidhur me personat fizik dhe juridik si mbi baza të gjinisë, gjuhës, opinionit politik ose opinionit tjetër, origjinës kombëtare ose sociale, pasurisë, lindjes ose ndonjë statusi tjetër, gjatë veprimtarisë administrative. Çdo person fizik dhe juridik ka të drejtë të (i) të marrë informacion që është në zotërim të një organi të administratës publike, (ii) të marrë informacion brenda një kohe të arsyeshme, (iii) në të njëjtën mënyrë si çdo person tjetër, dhe (iv) me mjete ose format të përshtatshëm dhe efektiv.
Ligji Nr. 04/L-020 për ndryshimin e ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë Nr. 03/L-047 i datës 21 dhjetor 2011	Përkufizon komunitetet e Kosovës dhe të drejtat e tyre speciale sa i përket identitetit të tyre, besimit, arsimit, përdorimit të gjuhëve, kulturës, shëndetit, medias, mundësive ekonomike dhe sociale, dhe përfaqësimit të tyre politik në të gjitha mekanizmat shtetëror. Ndërmerr masat për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare, programet për punësim publik, veçanërisht për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptas, arsimimin në gjuhën e tyre, etj.
Ligji për përdorimin e gjuhëve Nr. 02/L-37 i datës 21 tetor 2006	Rregullon përdorimin e gjuhëve zyrtare, si dhe të gjuhëve të komuniteteve, gjuha amtare e të cilave nuk është gjuhë zyrtare, në institucionet e Kosovës dhe në ndërmarrje dhe organizata të tjera publike. I ofron status të barabartë gjuhës shqipe dhe serbe si gjuhë zyrtare në Kosovë. Ofron të drejtën e të gjitha komuniteteve të Kosovës për të ruajtur, mirëmbajtur dhe promovuar identitetin e tyre gjuhësor.
Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi Nr. 05/L-021 i datës 15 qershor 2015	Përcakton kornizën e përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë, apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore,

Ligji	Përmbledhje dhe pikat kryesore
	shtatzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose çfarëdo baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë. Ka për qëllim të parandalojë të gjitha veprimet apo mosveprimet, e të gjitha institucioneve shtetërore dhe lokale, të personave fizik dhe juridik, të sektorit publik dhe privat, të cilët shkelin, kanë shkelur ose mund të shkelin të drejtat e çdo personi apo personave fizik dhe juridik, në të gjitha fushat e jetës, e posaçërisht që kanë të bëjnë me (i) qasjen në vendbanim, i cili është në dispozicion për publikun, si dhe qasjen në forma tjera të pronës (të luajtshme dhe paluajtshme) dhe (ii) trajtimin e drejtë dhe të barabartë para organeve gjyqësore dhe të gjitha organeve të tjera që administrojnë drejtësinë.
Ligji mbi barazinë gjinore Nr. 05/L-020 i datës 15 qershor 2015	Ka për qëllim të mbrojë dhe promovojë barazinë midis gjinive, si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë.
Ligji për planifikimin hapësinor Nr. 04/L-174 i datës 19 gusht 2013	Përcakton parimet bazë të planifikimit hapësinor, metodologjinë e zhvillimit dhe rregullimit hapësinor, si dhe përgjegjësitë e organeve administrative të nivelit qendror dhe lokal për hartimin dhe zbatimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor.
Ligji për ndërtim Nr. 04/L- 110 i datës 19 qershor 2012	Rregullon procedurën për lëshimin e lejeve ndërtimore, pajtueshmërinë me kërkesat e lejes ndërtimore dhe lëshimin e certifikatës së përdorimit, projektimit, ndërtimit, rindërtimit, rrënimin, mbikëqyrjen profesionale, inspektimin e ndërtimit.
Ligji për inspektoratin e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit Nr. 04/L-175 i datës 21 tetor 2013	Rregullon parimet, organizimin dhe mbikëqyrjen inspektuese, koordinimin e mbikëqyrjeve inspektuese, të drejtat, detyrat, autorizimet e inspektorit, të drejtat, detyrimet e subjekteve të mbikëqyrjes, procedurën për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese dhe çështje tjera me rëndësi që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen inspektuese. Parasheh që mbikëqyrja inspektuese dhe kontrolli përmes inspektimit urbanistik në zbatimin e këtij ligji dhe ligjeve tjera që kanë të bëjnë me fushën e urbanizmit dhe planifikimit hapësinor është përgjegjësi e Inspektoratit të planifikimit hapësinor dhe urbanistik.

Tabela 1: Legjislacioni në Republikën e Kosovës i rëndësishëm për zbatimin e projektit

2.3. KËRKESAT E BERZH-IT

BERZH aplikon Politikën e saj Mjedisore dhe Sociale (2014) në këtë Projekt. Përvetësimi i tokës mbulohet me Kërkesën e Performancës (KP) 5 të Politikës. Pikat kryesore të KP 5 janë si më poshtë:

- Duhet të hulumtohen të gjitha projekt dizajnet alternative të mundshme për të shmangur ose së paku minimizuar zhvendosjen fizike dhe / ose ekonomike, duke balancuar në të njëjtën kohë kostot dhe përfitimet mjedisore, sociale dhe ekonomike;
- Vendbanimet/risistemimet e negociuara inkurajohen të ndihmojnë në shmangien e shpronësimit dhe eliminimin e nevojës për të përdorur autoritetin qeveritar për t'i larguar njerëzit me forcë;
- Ndikimet e rënda/pafavorshme sociale dhe ekonomike nga përvetësimi i tokës ose kufizimet në përdorimin nga personat e prekur dhe qasjen në tokë duhet të lehtësohen nga: (i) sigurimi i kompensimit për humbjen e aseteve me koston e zëvendësimit; dhe (ii) të sigurojë që aktivitetet e përvetësimit të tokës të zbatohen me dhënien e informacioneve të duhura, konsultimin dhe pjesëmarrjen e informuar të atyre që preken;

- Mjetet e jetesës dhe standardet e jetesës së personave të zhvendosur duhet të përmirësohen ose, së paku, të rikthehen në nivelet e para-projektit;
- Banorët joformal të tokës nuk kanë të drejtë për kompensim të tokës; megjithatë, ata duhet të kompensohen për çdo përmirësim tjetër në tokë dhe t'u sigurohet asistencë për risistemimin/rivendosjen. Ata gjithashtu do të kompensohen me koston e plotë të zëvendësimit të çdo pasurie të humbur përveç tokës;
- Duhet të krijohet një mekanizëm i ankesave në proces sa më shpejt që të jetë e mundur, në mënyrë që të merren dhe adresohen në kohë shqetësimet specifike për kompensimin dhe zhvendosjen që ngrihen nga personat e zhvendosur dhe / ose anëtarët e komuniteteve nikoqire, duke përfshirë një mekanizëm rekursi të hartuar për të zgjidhur mosmarrëveshjet në mënyrë të paanshme.

2.4. KORNIZA INSTITUCIONALE PËR PËRVETËSIMIN E TOKËS NË KOSOVË

Në përputhje me Ligjin për Shpronësim të Kosovës, organi administrativ ("organi shpronësues") i cili është përgjegjës për shpronësimin e tokës për këtë Projekt është Qeveria e Kosovës përmes **Ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI)**, që vepron si autoritet shpronësues në emër të të gjitha autoriteteve të nivelit qendror¹⁰.

Institucionet tjera kyçe të përfshira në procesin e shpronësimit janë:

- **Zyra për Vlerësimin e Pasurisë së Paluajtshme** (brenda Departamentit të Tatimit në Pronë) në kuadër të Ministrisë së Financave, autoriteti i vetëm publik kompetent për vlerësimin e çdo prone të paluajtshme që i nënshtrohet shpronësimit nga çdo organ shpronësues (komuna ose Qeveria).
- **Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK)**, autoriteti më i lartë i kadastrës, gjeodezisë dhe kartografisë në Kosovë, përgjegjës për administrimin e përgjithshëm të regjistrit të kompjuterizuar të të drejtave mbi pronën e paluajtshme në Kosovë.
- **Zyrat Kadastrale Komunale**, që kërkohet të regjistrojnë (në Regjistrin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme) vendimet përfundimtare për shpronësimin e pronës së paluajtshme (të dorëzuara nga organi shpronësues) me qëllim që t'i pengojnë pronarët ose zotëruesit e interes të transferojnë ose t'i japin ndonjë personi të tretë ndonjë të drejtë pronësie ose të interesit apo të drejta tjera lidhur me pronën përkatëse, dhe të kryejnë ndonjë punë ndërtimore në pronën përkatëse.

2.5. ANALIZA E HENDEQEVE DHE MEKANIZMAT E PËRAFRIMIT

Tabela 2 ofron një pasqyrë të krahasimit të kornizës ligjore të Kosovës për shpronësimet dhe KP 5 të BERZH: Përvetësimi i tokës, kërkesat për risistemimet/rivendosjet jovullnetare dhe zhvendosjet ekonomike dhe veprimet që duhen ndërmarrë për të kapërcyer ndonjë mospërputhje të legjislacionit kombëtar me atë të kërkesave të BERZH-it.

Çështja	Dispozitat e Ligjit të Kosovës për shpronësim	Kërkesat e BERZH-it	Masa / Aktiviteti për të plotësuar hendekun
Shmangia ose minimizimi i zhvendosjes	Nuk ekziston asnjë dispozitë për shmangien ose minimizimin e zhvendosjes.	Shqyrtimi i projekt dizajnëve të mundshme alternative për të shmangur ose të paktën minimizuar zhvendosjen fizike dhe / ose ekonomike, duke balancuar kostot dhe	Projekti do të mundësojë shqyrtimin e rishtrirjeve/riarranzhimeve e mikro me qëllim që të shmangët përvetësimi i tokës aty ku është e mundur, në

¹⁰ Sipas Vendimit të Qeverisë Nr. 05/147 të datës 05 tetor 2010 Zyra e Shpronësimit u krijua në kuadër të MMPHI-së.

Çështja	Dispozitat e Ligjit të Kosovës për shpronësim	Kërkesat e BERZH-it	Masa / Aktiviteti për të plotësuar hendekun
		përfitimet mjedisore, sociale dhe financiare.	përputhje me parimet kryesore të përvetësimit / kompensimit të tokës të përcaktuara në PPTRJ.
Planifikimi dhe zbatimi i risistemimit/rivendosjes	Kërkohe vetëm një studim i shpronësimit si regjistrim bazë, nuk ka asnjë kërkesë të qartë lidhur me anketimet socioekonomike ose zhvillimin e planeve të risistemimit.	Duhet të bëhet një regjistrim dhe një vlerësim bazë socio-ekonomik për të identifikuar personat që do të zhvendosen dhe për të përcaktuar se kujt do t'i takojë kompensimi dhe asistencë si dhe duhet të përgatitet dhe të zbatohet një plan veprimi për risistemimin/rivendosjen.	Plani i Përvetësimit të Tokës dhe i restaurimit të Jetesës (PPTRJ) përmban një regjistrim të popullsisë dhe një studim socio-ekonomik dhe një matricë të të drejtave/titujve.
Vendosjet e negociuara	Nuk kërkon e as inkurajon vendosjet e negociuara.	Inkurajon vendosjet e negociuara për t'iu shmangur shpronësimit dhe për të eliminuar nevojën për të përdorë autoritetin qeveritar për largimin e njerëzve me forcë.	Vendosjet e negociuara do të realizohen aty ku është e mundur, madje edhe përpara fillimit të procesit të shpronësimit, në përputhje me parimet kryesore të përvetësimit / kompensimit të tokës të përcaktuara në PPTRJ.
Pranueshmëria/kualifikueshmëria për kompensim dhe formaliteti i pronësisë	Shpronësimi kryhet vetëm për pronën e paluajtshme dhe strukturat e ndërtimi në pronën e paluajtshme private. Procesi është i zbatueshëm vetëm për strukturat që janë të legalizuara ose që mund të legalizohen sipas ligjeve në fuqi në Kosovë në datën e nxjerrjes së vendimit përfundimtar për shpronësim.	Mungesa e dokumentacionit të pronësisë nuk përjashton nga kualifikimet për ndihmë të çdo bartësi të pretenduar ose pretendues të pronës, pavarësisht nga statusi i tyre formal.	Prona e paluajtshme duhet të kompensohet pavarësisht nga statusi i formalitetit.
Përdoruesit joformal të tokës dhe autorizimet	Përdoruesit joformal të tokës nuk njihen. Nuk ka dispozita mbi të drejtat e kësaj kategorie personash.	Kompensimi që do të sigurohet për përmirësime në tokë dhe humbje të aseteve të ndryshme nga toka dhe asistencë për rivendosje u ofrohet përdoruesve joformal të tokës me	Përdoruesit joformal të tokës të prekur nga humbja e aseteve dhe / ose përmirësimet në tokë do të marrin kompensim me koston e plotë të zëvendësimit.

Çështja	Dispozitat e Ligjit të Kosovës për shpronësim	Kërkesat e BERZH-it	Masa / Aktiviteti për të plotësuar hendekun
		kosto të plotë të zëvendësimit.	
Sigurimi i kompensimit në vlerë të zëvendësimit	Kompensimi paguhet në bazë të vlerës së tregut të pronës.	Kompensimi do të sigurohet me kosto të plotë të zëvendësimit, zakonisht i llogaritur si vlera e tregut e aseteve plus kostot e transaksionit që kanë të bëjnë me restaurimin / rikthimin e aseteve të tilla (taksat e regjistrimit dhe transferimit).	Personat e prekur nga humbja e përhershme e parcelave të tokës do të marrin kompensim me koston e plotë të zëvendësimit. Personat e prekur nga humbja e çfarëdo aseteve në token përkatëse do të marrin kompensim me kosto të plotë të zëvendësimit.
Rivendosja e jetesës	Nuk ka udhëzime specifike në rastet kur Nevojitet restaurimi i jetesës. Asnjë dispozitë në lidhje me konsultimin në lidhje me restaurimin e mjeteve të jetesës ose monitorimin. Udhëzimi Administrativ Nën-Ligjor MFNr. 02/2015¹¹ mbulon humbjen e të ardhurave dhe rritjen e shpenzimeve për pronën e shpronësuar dhe i konsideron ato si dëm (neni 14). Humbja e të ardhurave deri në restaurimin e biznesit në një lokacion tjetër kompensohet në bazë të të ardhurave 6 mujore dhe paguhet gjatë periudhës 6 mujore. Pagat për punëtorët e prekur paguhen gjatë periudhës 6 mujore.	Masat e restaurimit të jetesës duhet të zbatohen për të siguruar që njerëzit e prekur të rivendosin ose, nëse është e mundur, të përmirësojnë standardet e jetesës para projektit, jetesën dhe aktivitetet e punësimit. Masat mund të bazohen në tokë, burime, paga dhe / ose aktivitete afariste. Kompensimi do të sigurohet para zhvendosjes ose vendosjes së kufizimeve të qasjes Konsultimi me personat e prekur është thelbësor për të kuptuar pikëpamjet e tyre se si mund të rikthehen mjetet e tyre të jetesës.	Konsultimi me bizneset e prekura zbatohet si pjesë e sondazhit të dytë socio-ekonomik të ndërmarrë për këtë PPTRJ. Masat e restaurimit të jetesës, kompensimet dhe praktikatat e monitorimit të përcaktuara në PPTRJ.

¹¹ Udhëzimi Administrativ MeF-Nr. 02/2015 për miratimin e metodave të vlerësimit teknik dhe kriterëve për llogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme të shpronësuar dhe dëmet në lidhje me shpronësimin

Çështja	Dispozitat e Ligjit të Kosovës për shpronësim	Kërkesat e BERZH-it	Masa / Aktiviteti për të plotësuar hendekun
Data përfundimtare	Përcakton dispozitat mbi datën përfundimtare, por nuk kërkon që data e tillë të jetë mirë e dokumentuar dhe shpërndarë në të gjithë zonën e projektit. Sipas legjislacionit kombëtar, data përfundimtare do të jetë data kur Organi shpronësues publikon vendimin për pranimin e kërkesës për përpunim të mëtejshëm në Gazetën Zyrtare dhe në një gazetë që gëzon qarkullim të gjerë në Kosovë. Kompensimi nuk do të paguhet për koston ose vlerën për ndonjë përmirësim të pronës pas datës në të cilën është publikuar vendimi i pranimin të një kërkesë për përpunimin e mëtejshëm të shpronësimit në Gazetën Zyrtare, ose për çdo ndryshim në vlerën e tregut të pronës, pas qoftë datës së miratimit të vendimit që autorizon aktivitetet përgatitore ose datës së paraqitjes fillestare të kërkesës për shpronësim, cilado që është në rend e para. Data përfundimtare	Individët që lëvizin/shpërngulen në zonën e prekur të projektit pas datës përfundimtare nuk do të kenë të drejtën për kompensim dhe lloje të tjera të asistencës. Informatat në lidhje me datën përfundimtare do të dokumentohen mire dhe shpërndahen në të gjithë zonën e projektit.	Data përfundimtare do të shpalojë dhe shpërndahet publikisht në media dhe takime publike në komunitetet e prekura përkatëse, në përputhje me parimet kryesore të përvetësimit / kompensimit të tokës të përcaktuara në PPTRJ.

Çështja	Dispozitat e Ligjit të Kosovës për shpronësim	Kërkesat e BERZH-it	Masa / Aktiviteti për të plotësuar hendekun
	zbatohet për të drejtat formale ose të drejtat e njohura ligjore në pronë.		
Individët dhe grupet e cënueshme	Nuk ka masa të posaçme në lidhje me grupet e cënueshme.	Duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë grupeve të cënueshme.	Identifikimi i personave të cënueshëm të vlerësuar në këtë PPTRJ. Nuk është identifikuar asnjë person i tillë.
Mekanizmi i ankesave	Pronarët ose zotëruesit e interesave kanë të drejtë të paraqesin ankesa në faza të ndryshme të procesit (gjatë vlerësimit të nevojës për shpronësim dhe ligjshmërinë e procesit dhe gjatë përcaktimit të vlerës së pakos së kompensimit) dhe t'i paraqesin komente me shkrim autoritetit shpronësues gjatë procesit të konsultimit, por nuk ka kërkesa për mekanizëm specifik të ankesave për projektin. Nuk njihen procese të konsultimit joformal jashta mekanizmit të ankesave në dy faza të përshkruar më sipër.	Një mekanizëm i ankesave specifik për projektin duhet të krijohet sa më herët që është e mundur në proces, për të marrë dhe trajtuar me kohë shqetësimet specifike në lidhje me kompensimin dhe zhvendosjen që ngrihen nga persona të zhvendosur dhe / ose anëtarë të komuniteteve pritëse.	Procedura e ankesave është ngritur nga Plani i Angazhimit të Palës së Interesit (SEP) dhe është përfshirë në PPTRJ, dhe do të zbatohet nga MI.
Konsultimi dhe sigurimi i informacioneve	Autoriteti Shpronësues bën shpalosjen e informacioneve në vijim: njofton mbajtësin e pronës për kërkesën e paraqitur për shpronësim, publikon Vendimin për miratimin e kërkesës, mban një dëgjim public në komunën ku ndodhen pronat,	Informatat që gjenden në PPTRJ [dhe dokumentet e tjera të shpalosura siç është SEP (plani angazhimit të palëve të interesit)] duhet të shpalosen publikisht për të siguruar që njerëzit e prekur të kuptojnë procedurat e kompensimit dhe të dinë se çfarë presin në faza të ndryshme të projektit. Konsultimet me të gjitha	Përveç shpalosjes së informacionit të përcaktuar nga legjislacioni kombëtar, NJZP do të sigurojë që PPTRJ-ja të shpaloset publikisht dhe se dhënia e informacionit dhe konsultimet kryhen në përputhje me PPTRJ-në me të gjithë PPP-ët pavarësisht nga statusi i formalitetit. Kurrfarë të dhënash konfidenciale

Çështja	Dispozitat e Ligjit të Kosovës për shpronësim	Kërkesat e BERZH-it	Masa / Aktiviteti për të plotësuar hendekun
	njofton pronarët e prekur/mbajtësit e interesave për të drejtën e tyre për të parashtruar ankesë në gjykatën kompetente për të kundërshtuar Vendimin, publikon Vendimin Përfundimtar për pranimin ose refuzimin e kërkesës. Nuk ka dispozita mbi pronarët që mungojnë nga prona gjatë procesit të shpronësimit, pra nuk ka masa për të siguruar të drejtat e këtyre pronarëve që të informohen në kohë dhe si duhet për çdo veprim administrativ të ndërmarrë ndaj pronës së tyre dhe për mjetet efektive juridike Nuk ka dispozita mbi shpalosjen e informacionit ose konsultimet me palët e tjera të interesit që nuk janë identifikuar në Kërkesën për Shpronësim (p.sh. përdoruesit joformal)	PPP-ët (palët e prekura nga projekti) do të vazhdojnë gjatë gjithë ciklit të jetës së Projektit në përputhje me PPTRJ-në, d.m.th. ato do të ndërmerren gjatë zbatimit të kompensimit dhe monitorimit dhe vlerësimit të pagesës së kompensimit.	apo personale nuk do të shpalosen. Për sa i përket pronarëve të munguar të pronave MI duhet të angazhohet në mënyrë të qartë për të bërë përpjekje të arsyeshme për identifikimin e duhur dhe gjetjen e çdo pronari të munguar të pronave për të siguruar ofrimin me kohë dhe adekuat të informacionit dhe konsultimet në përputhje me PPTRJ-në.
Monitorimi i zbatimit të përvetësimit të tokës	Nuk ka dispozita.	Monitorimi i procesit të përvetësimit të tokës dhe restaurimit të jetesës do të bëhet nga zhvilluesi i projektit, i cili duhet të përfshijë pjesëmarrjen e palëve kryesore të interesit, siç janë njerëzit dhe komunitetet e prekura. Zhvilluesit të Projektit i kërkohet të përgatisë	Monitorimi do të bëhet nga Ministria siç përcaktohet në PPTRJ dhe SEP (plani angazhimit të palëve të interesit) me pjesëmarrjen e të gjitha palëve të interesuara dhe të prekura. Njësia për Zbatimin e Projektit në Ministri do të jetë përgjegjëse për monitorimin,

Çështja	Dispozitat e Ligjit të Kosovës për shpronësim	Kërkesat e BERZH-it	Masa / Aktiviteti për të plotësuar hendequn
		raporte të rregullta vjetore të progresit për procesin e përvetësimit të tokës dhe kompensimit së bashku me raportin e përfundimit të përvetësimit së tokës kur ai të jetë në dispozicion , e që duhet dërguar në BERZH.	mirëmbajtjen dhe përditësimin e rregullt të bazës së të dhënave për përvetësimin e tokës për pronarët/përdoruesit e pronave të prekura. Përmbledhje të raporteve të progresit do të publikohen në faqen e internetit të Ministrisë. Përveç kësaj, Ministria do të lehtësojë zhvillimin e një Auditimi të Përfundimit në fund të procesit të përvetësimit së tokës nga ana e një eksperti të pavarur.

Tabela 2: Analiza e hendeqeve që janë relevante për shpronësimin dhe mekanizmat e propozuar për afrues/tejkalues

3. INFORMATAT BAZË

3.1. REGJISTRIMI I PËRGJITHSHËM

Popullsia e prekur potencialisht dhe parcelat e tokës u identifikuan në bazë të dokumentacionit të disponueshëm të projektit për zgjerimin e rrugës për qasje në komunën e Gjilanit. U përdorën të dhënat kadastrale (të dhënat mbi pronësinë e saktë dhe gjendjen e përdorimit) nga Elaborati i Shpronësimit. Metodat shtesë të përdorura për grumbullimin e të dhënave për përgatitjen e Regjistrimit të përgjithshëm përfshinin observime në terren dhe ecje tërthore.

Regjistrimi i përgjithshëm i të gjithë PPP-ve përgjatë rrugës së projektit u zhvillua në mënyrë që të mblidhen dhe analizohen të dhënat dhe informatat e nevojshme për të identifikuar të gjitha kategoritë e ndikimeve. Baza e të dhënave të Regjistrimit të përgjithshëm përmban të dhëna për sa vijon:

1. vendndodhjen dhe Komunën Kadastrale,
2. numrin e parcelës së tokës,
3. llojin e parcelës së tokës,
4. llojin e identifikuar të ndikimit,
5. sipërfaqen e përgjithshme të parcelës së tokës (m²).

Baza e plotë e të dhënave është në formë të një dokumenti të veçantë në Excel. Informacioni konfidencial për personat dhe pronat individuale nuk do të shpaloset publikisht nga MI dhe/ ose BERZH.

Nga 1125 persona të vizituar, 5 prej tyre nuk u intervistuan për shkak të arsyeve të mëposhtme:

- 3 persona refuzuan të intervistoheshin ose nuk ofruan përgjigje ndaj pyetjeve të parashtruara;
- 2 ngastra ishin toka të pabanuara.

Të gjithë intervistuesit ishin të përkatësisë Shqiptare, më pak se 1% i përkisnin komuniteteve etnike si Romët. Rreth 90% e të intervistuarve ishin meshkuj ndërsa 10% ishin femra. Të anketuarit e intervistuar deklaruan se zona e ndikuar nga Projekti përdoret për aktivitete biznesi. Kryesisht, zona përdoret për qëllime tregtare. Rreth 60% e

pronarëve të ndërtesave e zotërojnë gjithashtu edhe biznesin, ndërsa 40% janë vetëm pronarë të biznesit.

Pritet që 66 persona të anketuar të preken nga marrja e tokës, siç tregohet në vijim:

- 55 persona me të drejtë formale mbi tokën (të regjistruar në Elaboratin e Shpronësimit) në komunat kadastrale Gjilan dhe Livoq i Epërm në komunën e Gjilanit;
- 22 parcela¹² në komunën kadastrale Koretishtë (Komuna e Novobërdës). Në atë kohë, nuk kishte listë të parcelave individuale me pronarët për këtë komunë, në Elaboratin e Shpronësimit, por vetëm të sipërfaqes së përgjithshme të tokës së prekur nga Projekti. Shpronësimi për këtë zonë kishte përfunduar në vitin 1974 dhe ndryshimet ishin pasqyruar më vonë në regjistrin kadastral gjatë muajit dhjetor 2017 (siç përshkruhet në seksionin 1.3.1 të këtij PPTRJ). Këta persona janë kompensuar për shpronësimin në epokën jugosllave. Përdoruesit joformal të tokës që kanë zënë këtë tokë që nga kjo kohë, do të kompensohen ende për çdo strukturë apo përmirësim të tokës, si dhe çdo ndikim jetësor.

Për shkak të ndryshimeve të fundit të projektimit në muajin maj 2019, u identifikuan edhe tre përdorues formal shtesë që do të preken nga marrja e tokës. Lloji dhe përmasat e ndikimeve të identifikuar janë elaboruar në seksionin 3.3 të këtij PPTRJ-je.

3.2. ANKETA SOCIO-EKONOMIKE

Anketa e parë socio-ekonomike është kryer gjatë korrikut 2017 për të kërkuar mendimet e PPP-ve lidhur me ndikimet e projektit dhe pagesat e kompensimit, si dhe për të marrë të dhëna specifike mbi jetesën aktuale dhe kushtet e jetesës së PPP-ve, duke përfshirë identifikimin e kategorive të cenueshme të PPP-ve.

Anketa është kryer në periudhën 13-16 korrik 2017 nga një ekip i anketuesve të trajnuar, në bazë të pyetësorëve të anketave të përgatitur nga ekspertë për përvetësim të tokës. Ekipi i anketuesve vizitoi pronat e identifikuar. Intervistat u zhvilluan me pronarët/përdoruesit e prekur që jetonin në parcelat e prekura të tokës ose të pranishëm në kohën e Anketës. Parcelat tokësore pa struktura ose pa askënd në to u regjistruan nga anketuesit në bazën e të dhënave të Regjistrimit të përgjithshëm.

Një anketë e dytë ishte kryer gjatë muajit shkurt 2018. Të dhënat e siguruar janë përdorur për të identifikuar shkallën e ndikimeve të biznesit/jetesës si dhe për të identifikuar dhe sugjeruar mundësitë për restaurimin e bizneseve/mjeteve të jetesës, përkatësisht për zhvillimin e këtij Plani të Përvetësimit të Tokës dhe Restaurimit të Jetesës.

Gjatë muajit nëntor dhe dhjetor 2018, një Kompani palë e tretë dhe ekspert i pavarur socio-ekonomik u angazhuan nga NjZP-ja që të ndërmarrin grumbullimin e të dhënave për asetet dhe bizneset të cilat do të preken. Rezultatet e anketës së tretë janë përdorur për të përcaktuar ndikimet e sakta në mjetet e jetesës dhe për të llogaritur kompensimin adekuat për humbjen e mjeteve të jetesës.

Gjatë periudhës gusht – shtator 2021, konsulenti u angazhua në zhvillimin e një ankete të mëtejshme për përditësimin e të dhënave mbi asetet dhe bizneset e prekura sipas elaboratit të ri të shpronësimit me referencë 233/2021, të datës 26.07.2021. Kjo anketë u krye për të kapur disa ndryshime të projektimit të cilat nuk ishin përfshirë në elaboratet e mëparshme. Pyetësorët u zhvilluan duke përdorur formatin e njëjtë si në anketën e mëparshme të shkurtit 2018, për të grumbulluar informacionin që mungon p.sh. llojin e

¹² Numri i përditësuar i parcelave të prekura të bizneseve është 20, nga të cilat 5 parcela janë toka publike. Pjesa tjetër prej 15 parcelave janë private në pronësi të gjithsej 11 shfrytëzuesve

biznesit, shkallën e ndikimit në biznes dhe mundësitë e restaurimit përkatësisht, shkallën e ndikimeve në jetesë dhe mundësitë e restaurimit të mjeteve të jetesës. U zhvilluan gjithsej 4 pyetësorë për dy struktura (gjithsej tre parcela). Nga 4 PPP-ët (të gjithë meshkuj) të intervistuar, dy prej tyre ishin pronarë biznesi dhe dy ishin pronarë ndërtesash. Dy PPP-ët tjerë shtesë refuzuan të përgjigjen. Të gjitha çështjet e ngritura nga PPP-ët kishin të bënin me ndikimin e rrugës në biznes (marrjen/dhënien me qira të strukturës ose funksionimin e biznesit).

Për qëllime të Anketës Socio-Ekonomike, janë përdorur tri lloje pyetësorësh, si më poshtë:

- (i) Pyetësori për pronarët e tokave (d.m.th. pronarët / shfrytëzuesit e parcelave të tokës pa struktura), dhe
- (ii) Pyetësori për familjet (p.sh. njerëzit që jetojnë në ose që përdorin strukturat banuese të prekura nga Projekti),
- (iii) Pyetësori për bizneset (p.sh. bizneset e vendosura në parcelën e tokës të prekur nga Projekti).

Përveç kësaj, çdo parcelë e tokës pa pronarë ose shfrytëzues të pranishëm u regjistrua nga anketuesit në bazën e të dhënave të Regjistrimit të përgjithshëm me të dhënat e mëposhtme: (i) vendndodhja, (ii) numri i parcelës kadastrale; (iii) e gjithë parcela e prekur (po / jo); (iv) strukturat fizike; (v) strukturat natyrore / kulturat; (vi) informacionin e marrë nga fqinjët, nëse ka.

Bizneset dhe aktivitetet e tyre si lloji kryesor i mjeteve të jetesës përgjatë kësaj pjesë të rrugës janë identifikuar edhe gjatë anketës së parë socio-ekonomike. Për shkak të faktit se të anketuarit nga anketa e parë nuk kanë dhënë informata mbi p.sh. të ardhurat vjetore, një anketë shtesë pasuese është realizuar gjatë muajit janar dhe shkurt 2018 për të mbuluar informatat që mungojnë, p.sh. ato për llojin e biznesit, shkallën e ndikimit mbi bizneset dhe mundësitë e restaurimit përkatësisht, shkallën e ndikimit në mjetet e jetesës dhe mundësitë e restaurimit të jetesës.

Për këtë qëllim janë zhvilluar tre Pyetësorë si më poshtë:

- (i) Pyetësori për pronarët e bizneseve dhe ndërtesave (d.m.th. pronarët e biznesit që zhvillohet në baza ditore në ndërtesën / strukturën në pronësi të pronarit të biznesit),
- (ii) Pyetësori për pronarët e bizneseve (d.m.th. pronarët qiramarrës të bizneseve që gjenden në strukturat që do të preken nga Projekti e që janë në pronësi të një pronari tjetër të ndërtesës),
- (iii) Pyetësori për pronarët e ndërtesës (d.m.th. pronarët e ndërtesave që gjenden në parcelën e tokës të prekur nga Projekti e që momentalisht nuk përdoren për të zhvilluar biznesin, por me potencial për t'u përdorur si struktura biznesi).

Lista e bizneseve të prekura është nxjerrë nga Planet e Përvetësimit të Tokës për Rugën për Qasje në Gjilan (nëntor 2017, të përditësuara në vitin 2018 dhe Shtator 2021) ku janë identifikuar si përdoruesit joformalë ashtu edhe ata formalë. Njësia për mbështetje të NjZP ka organizuar vizita dhe intervista me PPP-ët. Ekipi i anketuesve vizitoi pronat e synuara të identifikuar si lokacione të bizneseve të prekura për shkak të përvetësimit së tokës. Intervista u zhvilluan si me pronarët e biznesit ashtu edhe me punëtorët e biznesit të cilët i kanë bizneset e tyre të vendosura në parcelat e prekura të tokës dhe të cilët ishin të pranishëm në kohën e Anketës. Parcelat e tokave pa struktura apo pa askënd të pranishëm u regjistruan nga anketuesit në bazën e të dhënave të Anketës. Parcelat e tokës ku nuk ishte askush i pranishëm në vendngjarje u ri-kontaktuan nëpërmjet telefonit.

3.3. NDIKIMET E IDENTIFIKUARA

Sipas Elaboratit të Shpronësimit, seksioni i rrugës do të prekë 88 parcela të tokës në 2 komuna kadastrale (Gjilan dhe Livoq i Epërm) që ndodhen në komunën e Gjilanit. Nga këto, 40 parcela janë të listuara si tokë komunale ose si rrugë komunale (me një total prej 29,062.00 m²) dhe 48 janë në pronësi private (me gjithsej 5,309.50 m²) me pronarë të ndryshëm (një ose më shumë pronarë). Siç është cekur në këtë dokument, Elaborati I Shpronësimit për Komunën e Novobërdës është finalizuar në muajin dhjetor 2017, i cili përmban listën e parcelave individuale në Komunën e Novobërdës duke përfshirë të dhënat mbi pronësinë e parcelave, marrjen e tokës për secilën parcelë dhe përdorimin e tashëm dhe të ardhshëm të tokës. Bazuar në këto të dhëna, marrja e tokës për qëllimin e projektit në Komunën e Novobërdës arrin në 18,099,00m² në total, prej të cilave tokë private është 7,873 m² dhe pjesa tjetër prej 10,226 m² është tokë në pronësi publike. Sipas informatave nga NjZP, shpronësimi i tokës në Komunën e Novobërdës u përfundua në vitin 1974 dhe vetëm azhurnimi i regjistrit të kadastrës mbeti i papërfunduar deri në dhjetor 2017. Elaborati i Shpronësimit për një pjesë të seksionit rrugor të ndodhur në Komunën e Novobërdës, zona kadastrale Koretishtë (dhjetor 2017) është përdorur për të përditësuar këtë PPTRJ. Sipërfaqja e përgjithshme e tokës që do të kërkohej për qëllime të Projektit, duke përfshirë tokën që gjendet në territorin e Komunës së Gjilanit edhe të Novobërdës është 52,470.50 m² sipas Elaboreve të Shpronësimit (tokë private dhe publike)¹³.

Sipas Elaboratit, Projekti do të kërkojë përvetësimin e tokës prej 3 parcelave të plota publike të tokës, me një sipërfaqe totale prej 542 m² në komunën e Gjilanit. Toka e mbetur komunale është subjekt i shpronësimit të pjesshëm. Parcelat e tokës private do të preken kryesisht nga përvetësimi i pjesshëm i tokës, me përjashtim të katër parcelave që do të shpronësohen plotësisht (komuna e Gjilanit).

Për Komunën e Novobërdës, Projekti do të kërkojë përvetësimin e 5 parcelave të plota të tokës (tokë private), me një sipërfaqe totale prej 3,725 m². Toka e mbetur private dhe komunale është subjekt i shpronësimit të pjesshëm. Parcelat e tokave private do të preken kryesisht nga përvetësimi i pjesshëm i tokës, me përjashtim të pesë pesë parcelave të përmendura që duhet të shpronësohen plotësisht (Komuna e Novobërdës). Parcelat e prekura të tokës përdoren kryesisht për aktivitete të biznesit, d.m.th. për ruajtjen dhe/ose ekspozimin e përkohshëm të mallrave dhe materialeve para lokaleve afariste, ose si parkingje. Tabela 3 paraqet zbërthim të hollësishme të ndikimeve të projektit në pronën private lidhur me përvetësimin e tokës. Nuk mund të përcaktohej nga Elaborati i Shpronësimit nëse strukturat do të preken nga marrja e tokës. Megjithatë, siç është përcaktuar gjatë anketës së realizuar në qershor 2017, nuk pritet që ekonomitë familjare ose bizneset do të zhvendosen fizikisht si pasojë e zbatimit të Projektit. Gjithashtu, asnjë familje nuk do të largohet për segmentin e rrugës që ndodhet në Komunën e Novobërdës. Bazuar në të gjeturat nga sondazhi i dytë, I tretë dhe I katërt socio-ekonomik, priten ndikime të pjesërishme ndaj strukturave të biznesit për shkak të trazirave gjatë fazës së ndërtimit, si dhe ndikimet më të mëdha në biznesin që rezulton në zhvendosje ekonomike p.sh. biznesi nuk do të ishte i zbatueshëm për shkak të shpronësimit dhe ndikimeve në strukturat kryesore të biznesit gjatë ose pas zbatimit të projektit. Rrjedhimisht, tri biznese do të duhet të mbyllen në vendin e tanishëm, të kompensohen dhe të restaurohen në një vend tjetër. Sa i përket fazës së operimit të rrugës, ndikimi potencial është se disa nga bizneset mund ta humbasin qasjen që ata gëzojnë për momentin. Sidoqoftë, masa lehtësuese do të zbatohen.

¹³ Kjo përfshin tokën në Komunitatet e Gjilanit dhe Novobërdës.

Duka pasur në mendje ndryshimet e kohës së fundit të dizajnit gjatë vitit 2019 për shkak të modifikimit të rrethrotullimit marrja shtesë e tokës prej 303m² do të rezultojë në **sipërfaqen totale të marrë të tokës prej 52,773.5m²**.

Gjithashtu pritet që do të jetë e nevojshme për të zënë përkohësisht një numër parcelash private dhe shtetërore për qëllime të vendosjes së stafit, makinave dhe materialit. Sidoqoftë, në këtë fazë të dizajnit të Projektit, nuk janë definuar lokacionet e sakta të kampeve ndërtimore dhe ende nuk mund të ofrohen parashikime mbi numrin e parcelave të tokës private që mund të preken në këtë mënyrë. Megjithatë Ligji Vendor për Shpronësimet e konsideron shpronësimin e përkohshëm (neni 29), okupimin dhe shfrytëzimin e përkohshëm të çdo pasurie të paluajtshme private apo publike vetëm në qoftë se është e mundur që në një veprim të tillë:

- në rast se toka është e domosdoshme për zbatimin e masave urgjente të nevojshme për mbrojtjen e jetës, shëndetit ose pronës ose zbatimin ose rivendosjen e rendit publik; dhe
- masa të tilla bëhen të domosdoshme për shkak të një ngjarjeje madhore ose për shkak të luftës, trazirave, trazirave civile ose ngjarjeve të ngjashme të jashtëzakonshme.

Prandaj, kontraktuesi do të jetë përgjegjës për zbatimin e një plani të qasjes së tokës që është në përputhje me këtë PPTRJ.

Ndikimi	Komuna	Komuna Kadastrale	Numri i parcelave të tokës	Sipërfaqja e përafërt e tokës që i nënshtrohet shpronësimit(m ²)	Komente ¹⁴
Përvetësimi i plotë i tokës	Gjilan	Gjilan	4	1,797.00	-
		Livoq i Epërm	-	-	-
	Novobërda	Koretishtë	5	3,725.00	-
Përvetësimi i pjesshëm i tokës	Gjilan	Gjilan	22	1,818.40	-
		Livoq i Epërm	22	1,099.10	-
	Novobërda	Koretishtë	84	10,529.00	-

Tabela 3: Përmbledhja e ndikimeve të projektit lidhur me përvetësimin e tokës nga prona private

Përdoruesit/shfrytëzuesit formal:

Duke mbivendosur të dhënat kadastrale me dizajnin e Projektit, Konsulenti kishte mundësi t'i prodhonte ndikimet e pritura në strukturat e pranishme në parcelat private të listuara në Elaboratet e Shpronësimit për komunën e Gjilanit dhe të Novobërdës, siç tregohet në Tabelën 4. Në bazë të anketës, ishte verifikuar se strukturat e ndikuara që janë paraqitur (Tabela 4) në vijim nuk janë rezidenciale, prandaj nuk parashikohet zhvendosje fizike e pronarëve formal të tokës sipas Projektit. Parcelat e tjera të cilat nuk janë të listuara në këtë tabelë pritet të ndikohen vetëm nga marrja e tokës. Sidoqoftë, përmasat e ndikimit në PPP-ët formal do të verifikohet gjatë procesit të shpronësimit në përputhje me Ligjin për Shpronësim, gjatë vlerësimit të pronës dhe ky është vetëm informacion indikativ/tregues.

¹⁴Sipas Elaboratit të Shpronësimit të zhvilluar për këtë seksion

Nr.	Nr. i parcelës	Komuna	Lloji i biznesit të prekur	Shkalla e ndikimit të biznesit
1.	541-1	Gjilan	Shitje me pakicë e dritave/poqeve dhe materialeve elektrike	E plotë
2.	558-2 558-3 558-15	Gjilan	Stacion benzine	E plotë
3.	611-20	Gjilan	Materiale ndërtimore	E pjesërishtme (qasja në parcelë dhe objekt plato me zhavorr dhe kubëza betoni. Mure betoni)
4.	541-/12	Gjilan	Stacion benzine	E pjesërishtme (tendë)
5.	541-3/11	Gjilan	Dyqan mallrash të përziera	E pjesërishtme (qasja në parcelë dhe magazinë për material ndërtimor është plato me zhavorr)
6.	4907-1	Novobërda	Restorant	E pjesërishtme (qasja prej kubëzave të betonit)
7.	4907-2	Novobërda	Punime metalike	E pjesërishtme (qasja në parcelë plato prej betoni dhe zhavorri)
8.	4027-1 4028-1	Novobërda	Shitje me pakicë	E plotë Një pjesë e strukturës është prekur por mund të ketë nevojë për rrënim total për shkak të llojit të strukturës (beton i përforcuar)

Tabela 4: Përmbledhja e ndikimeve të projektit në lidhje me përvetësimin e tokës nga bizneset formale të anketuara në Komunën e Gjilanit dhe Komunën e Novobërdës¹⁵

Përdoruesit/shfrytëzuesit jo-formal:

Toka dhe/ose strukturat që do të merren nga personat pa pretendime formale mbi tokën nuk janë regjistruar në Elaboratin e Shpronësimit, pasi që Ligji për Shpronësim njeh vetëm pronarët formal.

Për të marrë të dhëna lidhur me ndikimet ndaj personave pa pretendime formale mbi tokën dhe që nuk janë të regjistruar në dokumentet zyrtare të shpronësimit, Konsulenti ka mbivendosur/krahasuar të dhënat kadastrale në dizajnin e Projektit dhe gjithashtu ka përdorur të dhënat e grumbulluara gjatë anketës së tretë socio-ekonomike dhe përmes konsultimeve me PPP-ët e prekura (ju lutem ta shtoni këtë sikur kjo të kishte ndodhur).

Tabela 5 ofron një pasqyrë të ndikimeve mbi PPP-ët pa pretendime formale mbi tokë. Të gjitha parcelat e prekura përdoren për aktivitete të biznesit, siç përshkruhet në seksionin 3.4.7 të këtij PPTRJ.

¹⁵ Informacioni për bizneset e prekura që ndodhen në territorin e Novobërdës është siguruar në bazë të projekt dizajnit nga Elaborati për Shpronësim për pjesën e rrugës për qasje në Gjilan në territorin e Komunës së Novobërdës (2017)

Nr.	Nr. i parcelës	Komuna	Lloji i biznesit të prekur	Shkalla e ndikimit të biznesit
9.	577-13	Gjilan	Dyqan shitjeje me pakicë (material ndërtimor)	E pjesërishme(qasja në parcelë është pllakë betoni)
10.	586-4	Gjilan	Auto mekanik / Palestër	E pjesërishme(qasja në parcelë është pllakë betoni)
11.	3984-21 3984-29	Novobërdë	Auto mekanik	E pjesërishme (qasja përbëhet nga pllaka të betonit)
12.	3960-5. 3960-14	Novobërdë	Dizajn Grafik	E pjesërishme(qasja në parcelë është pllakë betoni)

Table 5: Përmbledhja e ndikimeve të projektit në lidhje me përvetësimin e tokës nga bizneset joformale të anketuara në Komunën e Gjilanit dhe Komunën e Novobërdës

Siç tregohet në Tabelën 5, ndikimi në PAP-të joformal kufizohet në pjesë të vogla të strukturave të ngritura në parcela që janë të regjistruara formalisht në komunën e Gjilanit dhe Novobërdës. Sipërfaqet e prekura përdoren për ruajtjen e përkohshme të materialeve dhe mallrave dhe si parkingje. Të gjithë të anketuarit në Pyetësorët nga sondazhi i dytë social-ekonomik i synuar u përgjigjën se zona e parkimit nuk gjeneron të ardhura shtesë për biznesin dhe kështu nuk konsiderohet si lloj i jetesës por si strukturë mbështetëse e aktivitetit kryesor të biznesit.

3.4. NJERËZIT DHE PRONAT E PREKURA

3.4.1. Anëtarët e familjes

Asnjë ndërtesë banimi apo familje nuk do të preken nga shpronësimi i tokës si rezultat i zbatimit të projektit.

3.4.2. Përkatësia etnike

Duke pasur parasysh se çështja e përkatësisë kombëtare dhe/ose etnike është një çështje e ndjeshme socio-politike, të anketuarve u është dhënë mundësia për t'iu përgjigjur pyetjes në një format të hapur. 100% e të anketuarve (13/14 apo 91.6% e përgjigjeve të ofruara nga bizneset dhe pronarët e ekzaminuar, njëri nuk i përgjigjej pyetjes dhe një ekzaminues ishte punonjës në vend; 13/14 apo 91.6% ekzaminuan qiramarrësit e biznesmenëve, një ekzaminues nuk ofroi përgjigje për pyetjen dhe në dy lokacione nuk kishte të anketuar; 12/14 apo 85.71% ekzaminuan pronarët e ndërtesës, në tri lokacione nuk kishte të anketuar dhe dy të anketuar nuk ofruan përgjigje) u deklaruan si shqiptarë. Vetëm një rom është regjistruar si i punësuar në vend.

3.4.3. Prodhimi bujqësor

Asnjë tokë përgjatë seksionit të Projektit nuk përdoret për prodhim bujqësor.

3.4.4. Cenueshmëria

Marrë parasysh se seksioni i Projektit ndodhet në një zonë komerciale, gjatë regjistrimit të përgjithshëm nuk u identifikua asnjë grup i cenueshëm që do të prekej nga shpronësimi. Bazuar në gjetjet nga anketa e dytë e synuar socio-ekonomike, nuk u identifikua asnjë biznes i udhëhequr nga femrat.

3.4.5. Humbjet e përceptuara

Të anketuarve iu kërkua të rendisin çdo lloj të mundshëm humbjeje të shkaktuar nga Projekti në një shkallë prej 1-3 sipas rëndësisë së saj, me 1 ato të cilat janë më të rëndësishmet: humbja e konsumatorëve, pengimi i biznesit për shkak të aktiviteteve ndërtimore, dëmtimi i pajisjeve dhe të tjera ndikimet. Të anketuarit vunë re se ndikimi më i rëndësishëm ishte shqetësimi i përkohshëm i orëve të tyre të punës gjatë fazës së ndërtimit për shkak të pluhurit dhe zhurmës nga aktivitetet e ndërtimit. Siç u tha më lart, një strukturë biznesi e papërfunduar e cila është e prekur nga shpronësimi është planifikuar të përdoret si vendbanim në vendin 395-10 në tokën private (Gjilan/ZK Livoq i Poshtëm). Bazuar në gjetjet nga sondazhi i dytë socio-ekonomik, priten ndikime **të përhershme** dhe **të pjesërishme** ndaj strukturave të biznesit, të cilat lidhen me shqetësim të plotë gjatë ndërtimit ose me çrregullime të pjesërishme. Tri struktura kryesore të biznesit janë të prekura nga shpronësimi (parcela nr: 541-1 tokë private për shitje me pakicë të materialeve elektrike, parcela nr: 558-2, 558-3 dhe 558-15 e përdorur për stacion benzine dhe parcelat 4027-1, 4028-1 për shitje me pakicë) gjë e cila do të çojë në mbyllje të biznesit në këto lokacione. Të gjitha bizneset përdoren nga përdorues formal. Nga anketa e fundit, Techconsultant identifikoi një strukturë biznesi (stacion karburanti) e cila u zhvillua pas datës përfundimtare fillestare në parcelën 4017/4. Kjo tendë/ky kulm i strukturës mbivendoset në projektin e rrugës dhe do të ndikohet pjesërisht gjatë ndërtimit.

Sa i përket fazës së funksionimit, disa nga bizneset do të humbasin qasjen e tyre aktuale.

Shkalla e ndikimeve	Nr. i parcelës	Komuna		Statusi i formalitetit	Lloji i biznesit të prekur	Shkalla e biznesit të prekur	Gjithsej PAP të prekur
Priten ndikime të përhershme në strukturat e biznesit për shkak të shqetësimit të plotë gjatë ndërtimit	541-1	Gjilan		Formal	Shitje me pakicë e dritave/poqeve dhe materialeve elektrike	E plotë	8
	558-2 558-3 558-15	Gjilan		Formal	Stacion benzine	E plotë	5
	4027-1 4028-1	Novobërdë	Formal	Shitje me pakicë	E plotë		4
	Një pjesë e strukturës është prekur por mund të ketë nevojë për rrim total						
Priten ndikime të pjesërishme në strukturat e biznesit për shkak të shqetësimit të pjesshëm gjatë aktiviteteve të ndërtimit	611-20	Gjilan		Formal	Materiale ndërtimore	E pjesërishme (qasja në parcelë dhe objekt plato me zhavorr dhe pllakëza betoni. Mure betoni)	2
	541/12	Gjilan		Formal	Stacion benzine	E pjesërishme (tendë)	Refuzoi të përgjigjet
	541-3/11	Gjilan		Formal	Dyqan mallrash të përziera	E pjesërishme (qasja në parcelë dhe depo për material ndërtimor është plato me zhavorr)	6
	4907-1	Novobërdë		Formal	Restorant	E pjesërishme (qasja prej pllakave të betonit)	8

	4907-2	Novobërdë	Formal	Punime metalike	E pjesërishme (qasja në parcelë dhe objekt plato betoni dhe me zhavorr)	4
	577-13	Gjilan	Joformal	Dyqan shitjeje me pakicë(material e ndërtimore)	E pjesërishme (qasja në parcelë pllakë betoni)	8
	586-4	Gjilan	Joformal	Automekanik / Palestër	E pjesërishme (qasja në parcelë pllakë betoni)	1
	3984-21. 3984-29	Novobërdë	Joformal	Automekanik	E pjesërishme (qasja prej kubëzave të betonit)	6
	3960-5. 3960-14	Novobërdë	Joromal	Dizajn Grafik	E pjesërishme (qasja në parcelë pllakë betoni)	1

Tabela 6: Tabela përmbledhëse e humbjeve të përceptuara

3.4.6. Preferencat e kompensimit

Vetëm një i anketuar shprehu një preferencë kompensimi, duke thënë se ata do të ishin të kënaqur me kompensim monetar, përderisa PPP-ët e tjerë të anketuar nuk kishin preferenca ose kërkesa specifike për kompensim. PPP-ët (gjithsej 96) ofruan mbështetje me shkrim për Projektin në një deklaratë ku ata thanë se ata nuk kanë kërkesa specifike (shih Shtojcën 4 për përkthimin e letrës mbështetëse). Pritet që PPP-ët të kenë qenë të informuar mbi projektin dhe të drejtat pasi që shpalosja e informacionit është bërë në kohën e duhur. Ekipet në terren gjithashtu siguruan se informacionet dhe udhëzimet e nevojshme për qasjen institucionale u janë ofruar PPP-ve duke i kushtuar vëmendje që informacionet e ndjeshme të mos jepen, të tilla si ofrimi i emrave apo të dhënave specifike individuale.

Nga 96 PAP, 8.4% ishin pronarë ndërtesash dhe biznesesh (vetëm 7.7% femra) të cilët punësonin 44% të totalit të PPP-ve të identifikuar, 9% ishin pronarë biznesi (pa femra) që punësonin 30.5% të totalit të PPP-ve të identifikuar dhe 8.1% ishin pronarë ndërtesash (8.3% gra).

3.4.7. Bizneset

Sipas rezultateve të anketës, një total prej 12 biznesesh do të preken nga shpronësimi i tokës në pjesën e rrugës që ndodhet në Komunën e Gjilanit dhe Novobërdës siç përcaktohet në seksionin 3.3. Shumica e bizneseve të prekura punësojnë një deri në katër persona; ndërsa një numër i bizneseve punësojnë 6 - 8 persona dhe një biznes punëson 11 persona. Bizneset janë të llojit që nga stacionet e benzinës, dyqane të materialeve ndërtimore, punëtori automekanikësh, dhe restorante. Gjithsej, 2 prona shfrytëzohen nga përdoruesit joformalë të tokës në pjesën e rrugës që gjendet në Komunën e Gjilanit dhe 2 prona shfrytëzohen nga përdoruesit joformalë të tokës në pjesën e rrugës që gjendet në Komunën e Novobërdës, siç përcaktohet në Tabelën 6.

Nëse përdoruesit e tokave joformale nuk janë në gjendje të ofrojnë dëshmi të pronësisë në periudhën pasuese, atyre do t'u duhet ta kërkojnë të drejtën në përputhje me matricën e të drejtave të paraqitura në Tabelën 9 të këtij dokumenti. Të dhënat zyrtare të kadastrës (një kopje e listës poseduese dhe regjistrave të pronave të tjera të paluajtshme, planeve kadastrale dhe hartave që mbulojnë parcelën ose objektet përkatëse) përfshirë informacionet si pronari i parcelës, numri i parcelës, gjendja e përdorimit ose deklarata e gjykatës lidhur me tokën e trashëguar, kontrata e verifikuar e blerjes që përmban informacion mbi pronarin e mëparshëm/të ri të parcelës dhe të dhënat e tjera personale të identifikimit konsiderohen të jenë të vlefshme për ta dëshmuar mungesën e pronësisë.

Tabela 7 ofron informacionin mbi shkallën dhe llojin e ndikimeve të biznesit.

Shkalla dhe lloji i ndikimeve	Faza e projektit	Kategoria
Ndikimet e pjesërishme ndaj biznesit (p.sh. ndikimet ndaj strukturave, ndikimet në qasje, ndikimet në parkim), por biznesi mbetet i qëndrueshëm	Faza e ndërtimit dhe faza e operimit	Pronarët e bizneseve dhe ndërtesave / Pronarët e bizneseve
Ndikimet e pjesërishme ndaj biznesit (p.sh. ndikimet ndaj strukturave, ndikimet në qasje, ndikimet në parkim), por biznesi mbetet i qëndrueshëm	Faza e ndërtimit	Punonjësit
Humbja e qiramarrësve dhe humbja e të ardhurave nga qiramarrësit	Faza e ndërtimit dhe faza e operimit	Pronarët e ndërtesës që zotërojnë tokën / që nuk zotërojnë tokën ku vepron biznesi (ndërtesë e dhënë me qira)
Biznesi nuk është më tutje i suksesshëm (dmth. ndërtesat kryesore janë të ndikuara apo qasja është aq e kufizuar saqë biznesi nuk mund të operojë me fitim në atë vend)	Faza e ndërtimit dhe faza e operimit	Pronarët e bizneseve / pronarët e ndërtesave që zotërojnë tokën / që nuk zotërojnë tokën ku vepron biznesi
Biznesi nuk është më tutje i suksesshëm (dmth. ndërtesat kryesore janë të ndikuara ose qasja është aq e kufizuar saqë biznesi nuk mund të operojë me fitim në atë vend)	Faza e ndërtimit dhe faza e operimit	Punonjësit

Tabela 7: Përmbledhja e ndikimeve të lidhura me projektin në bizneset e prekura

Gjatë anketës së parë socio-ekonomike të zhvilluar në vitin 2017, të anketuarit nuk shpalosen të ardhurat e tyre mujore neto, kështu që nuk ishte e mundur të vlerësohet mundësia e humbjes së të ardhurave neto për shkak të aktiviteteve ndërtimore/operuese, të cilat parashikohen të zgjasin 24 muaj. Prandaj, një anketë e dytë e synuar u ndërmorr në vitin 2018, megjithatë vetëm disa prej të anketuarve iu përgjigjën kësaj pyetjeje të

veçantë mbi të ardhurat totale vjetore neto. Për llogaritjen përfundimtare të kompensimit zyrtari i burimit të informacionit do t'i referohet pagës së përcaktuar nga Këshilli Ekonomik Fiskal i cili ka përcaktuar pagën minimale në pagat e Kosovës dhe të ardhurave neto të nxjerra nga Administrata Tatimore e Kosovës (periudha fiskale 2016-2017). Do të zbatohet më e larta nga cilado prej këtyre dyjave (paga minimale dhe të ardhurat neto të nxjerra nga Administrata Tatimore). Për shkak të mungesës së të dhënave nga Elaborati i Shpronësimit, një anketë e tretë u zhvillua nga ekipi i konsulentëve në muajin shtator të vitit 2021. Gjatë kësaj ankete, ekipi zhvilloi sondazhin vetëm për bizneset e reja të zhvilluara nga koha e anketës së fundit apo që mungojnë nga kjo e fundit. Sondazhi i fundit nxjerri në pah disa ndryshime nga ai i mëparshmi, dhe pronarët që deklaruan të ardhurat mujore në përgjithësi.

Për informacione më të hollësishme mbi ndikimin e biznesit, ju lutemi referojuni Shtojcës 5.

Bazuar në informacionin nga sondazhi i dytë i synuar, pritet që për dy biznese Projekti do të shkaktojë humbje të përhershme të të ardhurave nga aktivitetet tregtare pasi strukturat kryesore të biznesit do të ndikohen nga shpronësimi dhe bizneset pritet të mbyllën apo/dhe të zhvendosen si rezultat i zbatimit të Projektit. Megjithatë, kompensimi do të paguhet për strukturat e prekura, humbjet e përkohshme të të ardhurave dhe për pagat e punëtorëve gjatë ndërprerjeve të përkohshme për shkak të fazës së ndërtimit. Për biznesin që do të preken përgjithmonë, duhet të sigurohet përkrahja në gjetjen e një lokacioni alternativ për biznesin, kompensimin për çdo shpenzim që lidhet me lëvizjen e biznesit të kompensuar, si dhe tranzicionin gjatë periudhës që duhet për të rivendosur biznesin në një vendndodhje alternative të mbështetur (kompensimi i periudhës së tranzicionit i mbuluar).

Ka mundësi që 9 biznese të mund të preken përkohësisht nga humbja e qasjes apo e zhurma/pluhuri/dridhjet/ shqetësimet e trafikut gjatë aktiviteteve të ndërtimit. Prandaj parcelat e specifikuar në Tabelën 8 do t'i nënshtrohen zbatimit me kohë të masave lehtësuese për të shmangur shqetësimet e përkohshme dhe ndikimet e pjesërishme për bizneset, si p.sh.:

- Spërkatja me ujë e sipërfaqeve për të parandaluar pluhurosjen
- mirëmbajtja e qasjes në biznese në çdo kohë dhe kufizimi i humbjes së qasjes vetëm në orët jashtë orarit të punës
- organizimi adekuat i lokacionit ndërtimor për të mirëmbajtur qasjen në biznes
- monitorimi i zhurmës së ndërtimit dhe masat shitesë lehtësuese për të kufizuar ndikimin gjatë orarit të punës
- kryerja e vlerësimit vizual të ndërtesës/strukturës para ndërtimit nga ana e Kontraktorit për të lehtësuar hetimin gjatë pretendimeve të mundshme për çarje të reja dhe dëmtime strukturore për shkak të dridhjeve.
- monitorimi i zbatimit të masave të sugjeruara.

Shkalla e ndikimeve	Nr. i parcelës	Komuna	Statusi i formalitetit	Lloji i biznesit të prekur	Shkalla e ndikimit në biznes	Gjithsej PAP të prekur
Priten ndikime të pjesërishme në strukturat e biznesit për shkak të shqetësimit të pjesshëm gjatë aktiviteteve të ndërtimit	611-20	Gjilan	Formal	Materiale ndërtimore	E pjesërishme (qasja në parcelë dhe objekt plato me zhavorr dhe pllakë betoni. Mure betoni)	2
	541/12	Gjilan	Formal	Stacion benzine	E pjesërishme (tendë/kulm)	Refuzoi të përgjigjet
	541-3/11	Gjilan	Formal	Dyqan mallrash të përziera	E pjesërishme (qasja në parcelë dhe depo për material ndërtimor është plato me zhavorr)	6
	4907-1	Novobërdë	Formal	Restorant	E pjesërishme (qasja prej pllakave të betonit)	8
	4907-2	Novobërdë	Formal	Punime metalike	E pjesërishme (qasja në parcelë plato betoni dhe me zhavorr)	4
	577-13	Gjilan	Joformal	Dyqan shitjeje me pakicë(materiale ndërtimore)	E pjesërishme (qasja në parcelë pllakë betoni)	8
	586-4	Gjilan	Joformal	Automekanik / Palestër	E pjesërishme (qasja në parcelë pllakë betoni)	1
	3984-21. 3984-29 558-3	Novobërdë	Joformal	Automekanik	E pjeshme (qasja prej kubëzave të betonit)	6
	3960-5. 3960-14	Novobërdë	Joformal	Dizajn Grafik	E pjesërishme (qasja në parcelë plato betoni)	1

Tabela 8: Masat lehtësuese që do të zbatohen gjatë fazës së ndërtimit në parcelat e përzgjedhura

Duke patur në mendje se ka ndikime që kanë të bëjnë me fazën e operimit pasi që pritet që bizneset e prekura të jenë plotësisht të ndikuara, gjithashtu edhe kjo fazë e projektit do të merret parasysh për kompensim. Masat e domosdoshme të restaurimit të jetesës janë megjithatë të zbatueshme para fazës së ndërtimit të rrugës.

4. PARIMET KRYESORE TË KOMPENSIMIT, PËRKUFIZIMET DHE ÇËSHTJET

Parimet e mëposhtme të përvetësimit të tokës dhe kompensimit janë marrë përsipër nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës së Kosovës dhe do të respektohen gjatë zbatimit të Projektit:

1. **Përvetësimi i tokës** do të kryhet në përputhje me *Ligjin për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme në Kosovë*, Politikën Mjedisore dhe Sociale të BERZH-it 2014 dhe Kërkesën e saj të Performancës 5 (*Përvetësimi i Tokës, Rsisistemimi/Rivendosja Jovullnetare dhe Zhvendosja Ekonomike*), këtë PPTRJ dhe me praktikën e mira ndërkombëtare. Projekti do të mundësojë marrjen parasysh të mikro rishtirjeve/riarranzhimeve me qëllim që të shmangët përvetësimi i tokës aty ku është e mundur.
2. **Të gjithë personat e prekur do të njoftohen** dhe konsultohen gjatë përgatitjes dhe zbatimit të Projektit. Të gjithë pronarët, banorët dhe shfrytëzuesit do të vizitohen dhe do t'iu shpjegohet procesi i përvetësimit të tokës si dhe ndikimet specifike në tokën e tyre, në atë mënyrë që të jepet mundësia për të bërë mikro riarranzhime/rishtirje për të zvogëluar ndikimet dhe shqetësimet e mundshme.
3. **Vendosje të negociuara do të kryhen** aty ku është e mundur për të ndihmuar në eliminimin e nevojës për të përdorur autoritetin qeveritar për t'i larguar njerëzit me forcë.
4. **Plani i detajuar i Përvetësimit të Tokës dhe Restaurimit të Jetesës (PPTRJ) në përputhje me KP 5** do t'i nënshtrohet konsultimit publik. Çdo informacion/e dhënë për pronat dhe personat e prekur në PPTRJ do të trajtohet si informacion konfidencial dhe nuk do të shpaloset publikisht nga Ministria, ndonjë Komunë dhe/apoi BERZH-i.¹⁶ PPTRJ-ja bazohet në informacione të besueshme, të përditësuara dhe përmban informata themelore për Projektin, ndikimet e Projektit, njerëzit e prekur dhe pasuritë (asetet), të drejtat e të gjitha kategorive të njerëzve të prekur si dhe çdo çështje ligjore që lidhen me risistemimin/rivendosjen ose ndonjë hendek në mes legjislacionit të Kosovës dhe KP 5. **Anketa bazë/pikënisje socioekonomike dhe regjistrimi** për PPTRJ-në kanë identifikuar si shfrytëzuesit formal ashtu edhe ata joformal të tokës/pronës.
5. **Data përfundimtare** për konstatimin e të drejtës/kualifikueshmërisë **për pronarët/përdoruesit formal të tokës** do të jetë **data në të cilën vendimi për pranimin e kërkesës**¹⁷ për procedim të mëtejshëm të shpronësimit (lëshuar para Vendimit preliminar) publikohet në Gazetën Zyrtare. Personat që janë vendosur në zonën e Projektit pas datës përfundimtare nuk do të kenë të drejtë për çfarëdo kompensimi.¹⁸ Data përfundimtare do të shpaloset dhe shpërndahet publikisht në media dhe takime publike në komunitetet e prekura përkatëse.

Në përputhje me *Ligjin për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme*, nga shuma e kompensimit do të përjashtohen si më poshtë:

- kostoja ose vlera e çfarëdo përmirësimi që i është bërë pronës, objekteve të ndërtuara ose të zgjeruara në pronë, ose pemëve dhe kulturave të mbjella në pronë pas datës në të cilën vendimi për pranimin e kërkesës për procedim të mëtejshëm të shpronësimit (lëshuar para Vendimit preliminar) është publikuar në Gazetën Zyrtare,
- çfarëdo ndryshimesh në vlerën e tregut të pronës që ndodhin qoftë pas datës së miratimit të vendimit që autorizon aktivitetet përgatitore për atë pronë ose datës së dorëzimit fillestar të kërkesës për shpronësim, cilado që paraqitet më herët,
- dhe çfarëdo ndryshimi tjetër në vlerën e tregut të pronës para fillimit të procedurës së shpronësimit, nëse dëshmohet se ndryshimet e tilla mund t'i atribuohen manipulimit të çmimit ose manipulimit të tregut ose spekulimit nga

¹⁶ PPT-ja që përmban informacion/të dhëna konfidenciale do të quhet "vetëm për përdorim të brendshëm" dhe një version i dytë i PPT-së i quajtur "version public" nuk do të përmbajë informacione/të dhëna të tilla

¹⁷ Vendimi është ende i hapur për shkak të përditësimeve shtesë të shpronësimit të pjesshëm.

¹⁸ Një ndërtim i kohëve të fundit në tokën e shpronësuar pas datës përfundimtare fillestare është bërë në zonë (një pikë karburanti) e cila tani është prekur nga ndërtimi i rrugës. Leja e ndërtimit për këtë është dhënë nga pushteti vendor dhe qendror.

personat (ose të afërmit ose bashkëpunëtorët e tyre) të cilët ishin në dijeni të informacionit lidhur me shpronësimin e afërt ose të mundshëm të pronës.

6. **Të gjithë pronarët, banorët apo shfrytëzuesit** e tokës së prekur në kohën e datës përfundimtare, me ose pa të drejta të plota të pranuar të pronësisë, **kualifikohen për kompensim dhe/ose ndihmë**, ashtu siç parashihet në Matricën e të Drejtave (Tabela 9 e këtij dokumenti).
7. **Zënia e përkohshme** e tokës për qëllime të ndërtimit do të kompensohet në përputhje me *Ligjin për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme*, ashtu siç parashihet në Matricën e të Drejtave (Tabela 9 e këtij dokumenti).
8. **Standardet e jetesës dhe/apo mjetet e jetesës** së personave të prekur do të rivendosen/restaurohen, mundësisht edhe të përmirësohen, në një periudhë kohore sa më të shkurtër që është e mundur.
9. **Vlerësimi zyrtar i pasurive/përmirësimeve në tokë** do të kryhet nga vlerësues të certifikuar të caktuar nga Zyra për Vlerësim të Pronës së Paluajtshme (Departamenti i Tatimit në Pronë në kuadër të Ministrisë së Financave) apo nga vlerësues të certifikuar të përzgjedhur në bazë të procedurës së prokurimit publik.
10. **Kompensimi** do të ofrohet para përvetësimit të tokës. Çështjet e ndërlidhura me pagesën e kompensimit në mjete monetare, do të diskutohen dhe dakordohen me pronarët dhe të gjithë pjesëtarët e amvisërive të prekura. Kompensimi në mjete do të paguhet në tërësi në llogaritë bankare të specifikuara nga pronarët, në marrëveshje me të gjithë pjesëtarët e prekur të amvisërive. Në rastet kur ka më shumë se një pronar të pronës, (gjegjësisht, bashkëpronësi nga çiftet e martuara), shumat e kompensimit do të ndahen dhe do të paguhet në llogari bankare të cilat ata i specifikojnë.
11. **Njerëzve të prekur nga Projekti dhe komuniteteve do t'iu sigurohen informacione dhe do të konsultohen** në mënyrë që t'iu lehtësohet pjesëmarrja e hershme dhe e informuar në procesin e vendimmarrjes lidhur me përvetësimin e tokës.
12. **Qasja në informata dhe ndihma për personat/amvisëritë e cenueshme** do të lehtësohet nga MI-ja dhe Komuna, varësisht prej nevojave të tyre specifike, në bazë të shqyrtimit për secilin rast veç e veç, të kryer me ndihmën e Zyrës për Vlerësim të Pasurisë së Paluajtshme (në kuadër të Ministrisë së Financave) dhe departamenteve përkatëse sociale të Komunës.¹⁹
13. Do të themelohet një **mekanizëm efektiv i ankesave** për pranimin dhe shqyrtimin e shqetësimeve specifike me kohë, përkritazi me kompensimin dhe zhvendosjen, të ngritura nga personat e zhvendosur.
14. MI-ja do të **monitrojë zbatimin e procesit të përvetësimit të tokës**, si përmes aranzhimeve të brendshme, zyrtare institucionale ashtu edhe përmes një monitoruesi të pavarur, të jashtëm. MI do të inkurajojë institucionet tjera, organizatat ndërkombëtare dhe OSHC-të vendore që të përfshihen në procesin e monitorimit (ju lutem shihni Kapitullin 7.3 për detaje).

5. KOMPENSIMI, TË DREJTAT DHE MASAT PËR RESTAURIMIN E JETESËS

Të gjithë personat që kanë zënë tokën e prekur nga Projekti, të regjistruar në regjistrim (pronarët dhe përdoruesit, si ata formal ashtu edhe ata joformal) kanë të drejtën e kompensimit dhe/ose të restaurimit të mjeteve të jetesës ose ndihmës tjetër siç është përshkruar në Tabelën 9.

Niveli dhe lartësia e ndihmës mund të ndryshojnë sipas kategorive të ndryshme të PPP-ëve, sipas ndikimit të identifikuar në Seksionin 3.3 të këtij PPTRJ-je. Strategjia e restaurimit të mjeteve të jetesës synon të rivendosë mjetet e jetesës së PPP-ve të cilët do të ndikohen përgjithmonë nga përvetësimi i përhershëm i tokës nga Projekti dhe gjithashtu nga

¹⁹ Lista indikative e aktiviteteve përfshin: takimet individuale për të shpjeguar kriteret e pranueshmërisë/kualifikueshmërisë dhe të drejtat që u takojnë, procesin e pagesave (gjegjësisht, për të siguruar që dokumentet e kompensimit dhe procesi i pagesave të kuptohen si duhet), ndihmë në periudhën pas pagesës për të siguruar të hollat e kompensimit dhe për të ulur rreziqet nga keqpërdorimi apo plaçkitja

shqetësimet e përkohshme nga punimet e ndërtimit deri në nivelet e para-projektit. PAP-të janë të vendosura përgjatë seksionit rrugor të Gjilanit në komunat Gjilan dhe Novobërdë. Jetesa/bizneset e PPP-ëve variojnë sipas llojit të biznesit, të ardhurave dhe numrit të punëtorëve dhe mundësisë nëse ato do të mbeten të qëndrueshme në lokacionin pas përfundimit të shpronësimit të tokës dhe aktiviteteve ndërtimore.

Lloji i ndikimit	Kategoria e PPP-ëve	E Drejta
HUMBJET E PËRHERSHME		
Humbja e përhershme e strukturave, tokës për ndërtim (duke përfshirë humbjen e qasjes në tokë në pronësi private ose tokë/burime publike).	Pronari i tokës	Kompensimi në mjete monetare me koston e plotë të zëvendësimit OSE Zëvendësimi i tokës për ndërtim
	Përdoruesi formal i tokës (qiramarrësi)	Informata për përvetësimin e tokës së paku tre muaj përpara hyrjes në posedim të tokës, për t'i mundësuar qiramarrësit të gjejë tokë tjetër për qira
	Përdorues joformal i tokës	Ndihma për identifikimin e tokës/burimeve zëvendësuese për përdorim, përpara hyrjes në posedim të tokës
Humbje e përhershme e strukturave jo-rezidenciale (strukturat kryesore të biznesit, strukturat ndihmëse të biznesit, gardheve, strehëve/kasolleve, etj.) dhe infrastrukturës - Biznesi për më tutje nuk është fitimprurës dhe i zbatueshëm në atë vendndodhje	Pronari i strukturës dhe infrastrukturës jo-rezidenciale (pronari i biznesit dhe i ndërtesës / pronari i ndërtesës) (biznesi formal ose joformal ose aktiviteti ekonomik)	Kompensimi në mjete monetare me koston e plotë të zëvendësimit DHE Kompensimi i zhvendosjes për asetet e luajtshme ose ndihma në zhvendosjen e tyre (nëse kërkohet) Mbështetja e tranzicionit gjatë periudhës e cila nevojitet për të ri-vendosur biznesin në një vend alternativ, por që nuk kalon në çfarëdo rasti kohëzgjatjen e projektit që pritet të zhvillohet në periudhën maksimale prej 24 muajve (kompensimi i periudhës së tranzicionit). Ofrimi i mbështetjes në gjetjen e lokacionit alternativ për biznesin. Kompensimi në të holla për të ardhurat e humbura gjatë fazës së ndërtimit dhe / ose pagat për punëtorët e punësuar në formën e pagës 6 mujore si pagesë në tranzicion.
Humbja e përhershme e qasjes për shkak të funksionimit të rrugës së re	Pronarët e bizneseve dhe të ndërtesave / Pronarët e ndërtesave	Sigurimi i qasjes së ngjashme ose të përmirësuar në vendndodhjen e biznesit. Asistencë në sigurimin e një aranzhimi alternativ të parkimit për biznesin dhe klientët e tij në qoftë se çështja e parkimit është prekur për një periudhë maksimale prej 24 muajve deri në finalizimin e projektit.

Lloji i ndikimit	Kategoria e PPP-ëve	E Drejta
Humbja e përhershme e vendit të punës dhe/apo burimeve të jetesës(zhvendosja e konomike) që rezultojnë me qasje më të vështirë në tokën dhe me ndikimet bezdisëse të ndërlidhura me ndërtimin(zhurma, pluhuri)	Punonjësit	Kompensimi i punonjësve për pagat e humbura për punëtorët e punësuar në formën e pagës 6 mujore si ndihmë për tranzicion OSE ofrimi i mbështetjes në gjetjen e punësimit alternativ (e një rëndësie të veçantë nëse biznesi mbyllet)
HUMBJET E PËRKOHSHME		
Humbja e përkohshme e tokës ndërtimore. Për përdoruesit e tokës, kjo i referohet qasjes në tokë në pronësi private ose tokës/burimeve publike	Pronari i tokës	Kompensimi në mjete monetare me koston e plotë të zëvendësimit për zënieën e përkohshme të tokës, në shumën e qirasë sipas çmimit të tregut DHE Restaurimi i tokës dhe infrastrukturës së prekur në kushtet e para-projektit DHE Kompensimi në mjete monetare për çfarëdo humbje/dëmtimi të aseteve (gjegjësisht, strukturat, gardhet, strehë/hangaret) me çmim të zëvendësimit
	Përdoruesi formal i tokës (qiramarrës)	Informatat për përvetësimin e tokës së paku tre muaj përpara hyrjes në posedim të tokës, për t'i mundësuar qiramarrësit të gjejë tokë tjetër të përshtatshme/ngjashme për qira
	Përdoruesi joformal i tokës	Asistenca për identifikimin e tokës/burimeve zëvendësuese të përshtatshme/ngjashme për përdorim, përpara hyrjes në posedim të tokës
Humbja e përkohshme e të ardhurave të biznesit dhe/ose mjeteve të jetesës (zhvendosja ekonomike) që rezultojnë nga qasja më e vështirë në tokë, ndikimet bezdisëse të ndërlidhura me ndërtimin (zhurma, pluhuri)	Pronari i biznesit dhe ndërtësës (biznesi formal ose joformal apo aktiviteti ekonomik)	Kompensimi në të holla për të ardhurat neto të humbura (ose të ardhurat e parashikuara joformale dhe/ose humbja e mjeteve të jetesës) gjatë periudhës së çrregullimeve Qasje alternative gjatë ndërtimit. Nëse nuk mund të sigurohet qasje alternative, kompensimi në të holla për të ardhurat e humbura gjatë fazës së ndërtimit dhe / apo pagat për kohëzgjatjen e ndikimit Asistencë në sigurimin e një aranzhimi alternativ të parkimit për biznesin dhe klientët e tij në qoftë se çështja e parkimi është prekur.

Lloji i ndikimit	Kategoria e PPP-ëve	E Drejta
Humbja e përkohshme e vendit të punës dhe/apo burimeve të jetesës(zhvendosja e konomike) që rezulton me qasje më të vështirë në tokën dhe me ndikimet bezdisëse të ndërlidhura me ndërtimin(zhurma, pluhuri)	Punonjësit	Nëse qasja alternative nuk mund të ofrohet, kompensoni pagat e humbura gjatë periudhës së ndërprerjes OSE ofroni mbështetje në gjetjen e punësimit alternativ.
Humbja e përkohshme e qiramarrësve dhe humbja e të ardhurave neto nga qiramarrësit	Pronarët e ndërtesës	Kompensimi në para për të ardhurat neto të humbura (ose të ardhurat e parashikuara joformale dhe / apo humbja e mjeteve të jetesës) gjatë periudhës së çrregullimit
Humbja e lokacionit me qira për të drejtuar biznesin dhe shqetësimet e përkohshme të biznesit gjatë ndërtimit	Pronarët e bizneseve (qiramarrësit)	Informacioni mbi përvetësimin e tokës së paku tre muaj përpara hyrjes në posedim të tokës, për t'i mundësuar qiramarrësit të gjejë ndërtesa të tjera për biznesin e tij për qira. Sigurimi i përkrahjes së tranzicionit gjatë periudhës që nevojitet për të ri-vendosur biznesin në një vend alternativ (periudha e tranzicionit deri në gjashtë muaj). Kompensimi në të holla për të ardhurat e humbura gjatë fazës së ndërtimit dhe /apo pagat për kohëzgjatjen e ndikimit.
HUMBJET E TJERA TË PAPËRCAKTUARA		
Çfarëdo ndikimi i papërcaktuar (humbje e përhershme ose e përkohshme)	Të gjithë PPP-ët	Çdo ndikim i papërcaktuar do të lehtësohet në përputhje si me Ligjin e Kosovës për Shpronësimin ashtu dhe me parimet dhe kërkesat e Politikës së BERZH-it. Në rast të mospërputhjeve në mes të Ligjit mbi Shpronësimin dhe Politikës së BERZH-it në një rast të veçantë, do të mbizotërojë dispozita më e favorshme për pronarin/përdoruesin e prekur

Tabela 9: Matrica e të drejtave

5.1. PËRLLOGARITJA E KOMPENSIMIT

Toka do të kompensohet në bazë të vlerës së tregut në përputhje me *Ligjin për Shpronësimin e Pronave të Paluajtshme në Kosovë* dhe gjithashtu në përputhje me Politikën Mjedisore dhe Sociale të BERZH-it 2014 dhe Kërkesën e saj të Performancës 5 (*Përvetësimi i Tokës, Risistemimi Jo vullnetar dhe Zhvendosja Ekonomike*) që të përfshijë edhe përdoruesit joformalë të tokës. Llogaritja përfundimtare është në proces e sipër dhe to përcaktohet nga Zyra për Pronën e Paluajtshme.

Strukturat do të kompensohen me kosto të plotë zëvendësimi (vlera e tregut + të gjitha taksat dhe kostot shtesë). Vlerësimi i strukturave do të bëhet gjithashtu nga Zyra për Pronën e Paluajtshme e cila l merr parasysh kriteret e tilla si: lloji i ndërtesës, materiali ndërtimor, sipërfaqja në m² për strukturat rezidenciale dhe jo rezidenciale, vitin e ndërtimit, qasjen në rrugë, shërbimet publike, sistemin e ngrohjes, gjendjen e objektit, kushtet e qiradhënies dhe të qirasë, koston e funksionimit dhe mirëmbajtjen etj.

Llogaritja e kompensimit për humbjen e të ardhurave të biznesit ose humbja e pagave për punëtorët llogaritet për rastet kur (i) biznesi është prekur rëndë dhe duhet të zhvendoset (zhvendosja ekonomike), prandaj periudha e tranzicionit duhet të mbulohet për paga (6 muaj paga si ndihmë tranzitore) dhe të ardhurat e biznesit (të ardhurat neto 6 mujore gjatë tranzicionit), dhe (ii) nëse qasja alternative nuk mund të sigurohet gjatë periudhës së shqetësimit. Për trazirat e përkohshme eventuale që rezultojnë nga punimet e ndërtimit, merret parasysh edhe kohëzgjatja e parashikuar e punëve ndërtimore për bizneset që kanë një plan për të vazhduar aktivitetin e tyre në të njëjtin vend pas përfundimit të kësaj faze. Kohëzgjatja maksimale e punimeve të ndërtimit është 24 muaj sipas dokumentacionit të tenderit, megjithatë pritjet të zgjasë më pak nëse punimet e ndërtimit në pjesë të veçanta të rrugës përfundojnë më shpejt. Për rastin e transferimit të biznesit në vend tjetër, parashikohet kompensimi për të mbuluar 6 muaj periudhë tranzicioni, meqë supozohet se gjatë kësaj periudhe PPP-ët mund ta rivendosin veprimtarinë afariste në një vend tjetër.

Llogaritja do të kryhet në bazë të të ardhurave vjetore neto (nëse dihen) dhe shumës së pagave. Zyra për Pronën e Paluajtshme merr përsipër llogaritjen e kompensimit në përputhje me ligjin vendor, respektivisht Zyrës i lejohet të kërkojnë raporte zyrtare nga bankat, në të cilat PPP-ët i kanë llogaritë e tyre bankare, raportet e taksave etj. ose të bëjnë një analizë krahasuese me biznesin e njëjtë apo të ngjashëm me fitimin / pagat e njohura.²⁰

Pasqyra e detajuar e të drejtave që do të shërbej si bazë për llogaritjen e kostove të kompensimit është dhënë në tabelat në Shtojcën 5. Këto llogaritje do të merren në konsideratë nga Zyra për Pronën e Paluajtshme për të llogaritur kompensimin për ndikimet e jetesës dhe për të siguruar masa adekuate për restaurimin e jetesës.

6. SHPALOSJA E INFORMATAVE DHE KONSULTIMET PUBLIKE

Kërkesat për shpalosje të informatave relevante për Projektin dhe për konsultimet publike, janë paraparë në Planin për përfshirjen e hisedarëve/palëve të interesit (PPH), të përgatitur nga MI-ja, në vitin 2015, me qëllim të përmirësimit të përfshirjes së hisedarëve, në përputhje me legjislacionin lokal dhe me kërkesat e BERZH-it.

Njësia e Zbatimit të Projektit (NJZP) është themeluar për Projektin, që përbëhet nga përfaqësuesit e MMPHI-së, përgjegjës për të siguruar zbatimin e duhur të PPT-së dhe përgjegjës për komunikimin me Komunën e Gjilanit dhe konsultimet me PAP-të, si dhe përfaqësuesit e Zyrave Lokale për Komunitete (ZLK).

NJZP-ja, së bashku me përfaqësuesit e Komunës së Gjilanit dhe MMPHI (përgjegjëse për shpronësimin) janë përgjegjës për komunikimin me komunitetet dhe njerëzit e prekur.

6.1. SHPALOSJA E INFORMATAVE DHE KONSULTIMET E MBAJTURA DERI MË TANI

Gjatë tri viteve të fundit, Komuna e Gjilanit dhe MMPHI-ja kanë mbajtur prezantime të Projektit në Komunë. Përfaqësuesit e organizatave joqeveritare lokale (OJQ), pakicat (si popullata rome), mediat dhe aktorët e tjerë u ftuan dhe i ndoqën në këto prezantime.

²⁰ Bazuar në informatat e dhëna nga Zyra e Pronës së Paluajtshme

Në korrik të vitit 2016 u mbajt një takim i përbashkët me MMPHI dhe Kryetarët e Komunave të Gjilanit, Kamenicës, Vitisë, Kllokotit, Ranillugut dhe Novobërdës për të diskutuar përmirësimet e infrastrukturës në sektorin rrugor në këtë zonë dhe rëndësinë e mbështetjes së MMPHI-së për komunitetet lokale.

Në shkurt të vitit 2017, në Komunën e Gjilanit u mbajt një dëgjim publik nga NJZP dhe kryetari i komunës për ndikimet mjedisore dhe ndikimet e tjera të zbatimit të projektit. Informacioni mbi debatin publik dhe nga këto takime u vu në dispozicion në faqen e internetit të MMPHI-së, në faqen e internetit të Komunës së Gjilanit si dhe në portalet e tjera të lajmeve²¹.

Në maj 2017, NJZP dhe zyrtarët komunal organizuan një vizitë tek të gjitha PPP-ët përgjatë rrugës së Projektit për të marrë mendimin e tyre mbi ndërtimin dhe ndikimet e perceptuara të zbatimit të Projektit. Me këtë rast, të gjitha PAP-të ofruan mbështetje për zbatimin e Projektit (shih Shtojcën 4).

Informata të shkurtra për Projektin u publikuan edhe në mediat lokale dhe në portalet online të lajmeve, si dhe faqen e internetit të MMPHI-së dhe Komunës.

Pakoja e shpalosjes të vigjilencës/kujdesit të duhur për vitin 2015 (PPH, PJT dhe KPT) (SEP, NTS, LAF) është publikuar në faqet e internetit të MMPHI-së dhe BERZH-it në anglisht, shqip dhe serbisht.

Ndërkohë parcelat që do të preken janë përcaktuar në Elaborat dhe janë përcaktuar të gjitha ndikimet e Projektit në lidhje me shpronësimin e tokës. Qeveria e Kosovës i ka njoftuar bartësit e identifikuar e së drejtës pronësore. Vendimi nr. 13/21²² për miratim është publikuar në Gazetën Zyrtare më 22.12.2017.

Më 16 janar 2018, PPT Rruga për Qasje në Gjilan është shpallur për publikun në tri gjuhë në faqen e internetit të MMPHI-së dhe të Komunës së Gjilanit dhe është përditësuar në tetor të vitit 2018. Seanca e parë publike në përputhje me legjislacionin vendor mbi procesin e shpronësimit është ndërmarrë më 16 janar 2018, në Komunën e Gjilanit përkatësisht:

- 16 janar për Komunën e Parteshit (zonat kadastrale: Partesh dhe Budrigë) dhe Komunën e Gjilanit si për Rikonstruksionin e seksionit rrugor Kllokot - Gjilan, ashtu edhe për seksionin rrugor të Rrugës për Qasje në Gjilanin (zonat kadastrale: Gjilan, Livoq i Epërm, Livoq i Ulët dhe Cërnice). Bazuar në informatat e dhëna në Procesverbalin e Takimit, gjithsej 72 pjesëmarrës. morën pjesë në konsultimet e para publike në këtë komunë. Pjesëmarrësit ishin të interesuar për pozicionin e linjave të shpronësimit dhe gjithashtu ngritën pyetje lidhur me qasshmërinë ndaj bizneseve, pikat e ardhshme të qasjes në pronat e tyre, parimet e kompensimit etj.
- Më 17 janar në Komunën e Vitisë (zonat kadastrale: Budrigë e Epërme dhe Radivojcë) dhe Kllokot (zona kadastrale Kllokot), e cila është relevante për këtë seksion rrugor të Rrugës për Qasje në Gjilan.

NjZP organizoi edhe takimin e konsultimit publik në përputhje me këtë PPTRJ, më 20.12.2018 në Komunën e Gjilanit, por asnjë palë e jashtme e interesuar, PAP etj. nuk

²¹ <http://mi-ks.net/sq/lajme/njoftim-per-debat-publik-1160> - Ky link më nuk është aktiv, por një regjistrim i informacionit është arritur nga Njësia e Implementimit të Projektit - Ministria e Infrastrukturës
<https://kk.rks-gov.net/gjilan/News/Prezantohet-projekti-i-Autostrades-Prishtine-Gjila.aspx> - Ky link më nuk është më aktiv, por një regjistrim i informacionit është arritur nga Njësia e Implementimit të Projektit - Ministria e Infrastrukturës

<http://www.kosovapress.com/sq/lajme/ndertimi-i-rrugeve-me-kater-korsi-gjilan-prishtine-dhe-gjilan-ferizaj-nis-ne-maj-101708/>

²² Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=15826>

morën pjesë në takim. Të pranishëm në takim ishin përfaqësuesit e Komunës së Gjilanit, drejtori i NJZP-së, anëtarët e NJZP-së dhe Konsulenti për Mbështetjen e NJZP-së. Takimi u shty dhe u organizua gjatë vitit 2019, pas finalizimit të të gjitha ndryshimeve të projektimit dhe shpalosjes publike të PPTRJ-së së re, dhe para fillimit të punimeve ndërtimore. Një takim tjetër ishte parashikuar të organizohej brenda muajit shtator 2021 kur u zgjodh Inxhinieri/Mbikëqyrësi i ri, por të gjitha mbledhjet publike shtyhen për shkak të kufizimeve në lidhje me COVID-in.

6.2. MJETET E KOMUNIKIMIT NË DISPOZICION

MI-ja përdorë kanalet e mëposhtme të përfshirjes së hisedarëve, të komunikimit dhe shpalosjes së informacionit:

- Publikimi i informacionit në faqen zyrtare të internetit të MMMHI-së (<http://miks.net>)²³, e cila është e organizuar mirë dhe përmban informacione relevante kontaktuese dhe lajme;
- Publikimi i informacionit në tabelat e shpalljeve publike në hapësirat e MMPHI-së;
- Përgjigjja në pyetjet me telefon, postë, faks ose e-mail;
- Shpalljet publike të komunikuara në media (radio lokale /TV stacione, gazeta ditore, etj.) në bazë të nevojave.

6.3. SHPALOSJA E PLANIFIKUAR E INFORMACIONEVE DHE KONSULTIMET

MI do të kryejë konsultime publike dhe shpërndarjen e informacionit që do të pasqyrojë çështjet kryesore që kanë lidhje me Projektin gjatë ecursisë së progresit përmes fazave vijuese të zbatimit (Zhvillimi dhe zbatimi i mekanizmave të ankesave dhe takimet pas zbatimit të projektit). Të gjithë hisedarët do të informohen me kohë në lidhje me fushëveprimin e Projektit dhe kontaktet për tu informuar më tej, si dhe disponueshmërinë e dokumenteve që janë në dispozicion të publikut.

6.3.1. Dokumentet dhe informacionet që do të shpalosen

MI-ja ka shpalosur dhe/apo synon të shpalosë dokumentet dhe informacionet e mëposhtme në lidhje me Projektin:

- Këtë Plan për Përvetësimin e Tokës dhe Restaurimin e Jetesës (PPTRJ) (versioni i parë i PPT-së është publikuar në muajin janar të vitit 2018 dhe është përditësuar në muajt tetor 2018, mars 2019 dhe tetor 2021);
- Informacionin mbi shëndetin e komunitetit dhe rreziqet dhe ndikimet në siguri (duke përfshirë çdo punë ndërtimore, kufizime në qasjen rrugore dhe shqetësime të tjera), masat e propozuara lehtësuese dhe përditësimet lidhur me ecurinë e zbatimit të Projektit;
- Përmbledhjen e konkluzioneve nga takimet konsultative dhe diskutimet publike të mbajtura;
- Përmbledhjen jo teknike e Vlerësimit Mjedisor dhe Social të Projektit (e shpalosur në vitin 2015);
- Plani i Përfshirjes së Hisedarëve (PPH) (i shpalosur në vitin 2015 dhe që do të përditësohet përpara aktiviteteve të ndërtimit);
- Formulari i Ankesave (shih Shtojcën 2);

Dokumentet do të jenë në dispozicion në gjuhën shqipe dhe serbe (po ashtu edhe anglisht kur janë në dispozicion) menjëherë pas fillimit të Projektit (por të paktën 30 ditë para fillimit të punëve ndërtimore - periudha që shërben për mbledhjen e vërejtjeve,

²³ Ky link nuk është më aktiv, por një regjistrim i informacionit është arritur nga Njësia e Implementimit të Projektit - Ministria e Infrastrukturës

sugjerimeve dhe propozimeve të publikut) në faqet e internetit të MMPHI-së dhe komunës së

Gjilanit, si dhe në kopje të shtypura mund të vihen në dispozicion pas kërkesës nga hisedarët në ambientet e MMPHI-së dhe komunës së Gjilanit në adresat e mëposhtme:

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Adresa: Ndërtesa e Odës Ekonomike, Kati i parë, Zyra nr. 2, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës

Adresa: Bulevardi i Pavarësisë p.n., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës

Këto dokumente dhe informacione do të mbeten në domenin publik gjatë gjithë kohëzgjatjes së ciklit të Projektit.

6.3.2. Takimet e planifikuara

Komuna do të planifikojë dhe do të mbajë takimet e mëposhtme me përfaqësuesit e grupeve të ndryshme të hisedarëve:

- Takimet konsultative publike do të mbahen rregullisht, të paktën çdo 6 muaj, gjatë përgatitjes dhe zbatimit të Projektit, gjegjësisht para dhe gjatë punëve të ndërtimit. Takimi i ardhshëm publik ishte planifikuar të organizohet para nisjes së punëve të ndërtimit nga Inxhinieri/Mbikëqyrësi i ri i cili ishte zgjedhur në shtator të vitit 2021, por ë gjitha takimet publike u shtynë për shkak të kufizimeve të ndërlidhura me COVID-in. Takimet e tilla në të ardhmen do të synojnë mbajtjen e mbledhjeve të rregullta të të gjithë hisedarëve të interesuar dhe do të jenë të hapura për të gjitha palët e interesuara. Gjatë këtyre takimeve, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të paraqesin mendimet dhe vërejtjet e tyre në lidhje me Projektin, si dhe të sugjerojnë zgjidhje të mundshme të çështjeve të ngritura, të cilat do të dokumentohen dhe trajtohen në mënyrë të duhur në Raportet e Monitorimit të Zbatimit të Projektit në lidhje me ankesat e pranuar dhe veprimet pasuese të ndërmarra që duhet të përgatiten nga NjZP-ja. Këto takime do të mbahen në hapësirat e Komunës.
- Takimet konsultative të Komunitetit Lokal kanë për qëllim përfshirjen e individëve, ekonomive familjare dhe bizneseve të prekura nga aktivitetet e ndërtimit në procesin e konsultimit dhe do të organizohen në bazë të nevojave në Komunitetet Lokale.
- Takimet individuale konsultative kanë për qëllim përfshirjen e grupeve individuale të hisedarëve në lidhje me çështje specifike dhe do të organizohen në bazë të nevojave. Ky lloj i takimeve mund të iniciohet nga Komuna, MI-ja ose nga çfarëdo grupi/individë të identifikuar të hisedarëve.

6.3.3. Orari i takimeve publike

Orari dhe vendi i caktuar për takimet publike konsultative do të përcaktohet saktësisht nga NjZP pas përcaktimit të datës së fillimit të projektit. Të gjithë hisedarët/palët e interesit do të informohen mbi datën, kohën dhe vendin e saktë ku do të mbahet takimi konsultativ, të paktën 7 ditë përpara, përmes publikimit në faqe të internetit dhe tabelës të njoftimeve të MMPHI-së dhe Komunës, si dhe në mediat lokale (gazetat, portalet online të lajmeve) sipas nevojës.

Të gjitha informatat dhe dokumentet e disponueshme të Projektit do të shpalosen për publikun para takimit të parë, të paktën 7 ditë më herët.

7. ZBATIMI I PPTRJ-SË**7.1. PËRGJEGJËSITË PËR ZBATIM**

Të gjitha palët e përfshira në Projekt, duke përfshirë MMPHI, MF (përkatësisht Zyrën për Vlerësimin e Pronës²⁴), Komunitatet relevante dhe Kontraktuesi që do të angazhohet nga MMPHI për të punuar në lokacionet e Projektit, duhet të zbatojnë dispozitat e këtij PPTRJ-je. Përgjegjësitë do të ndahen ndërmjet MMPHI-së, MF-së, Komunitet të Gjilanit, Kontraktuesit dhe agjencive të tjera, sipas Tabela 10.

NjZP-ja e themeluar brenda MMPHI-së do të sigurojë zbatimin e duhur të PPTRJ-së dhe do të jetë përgjegjëse për komunikimin me komunitetet dhe konsultimet me PAP (njerëzit e prekur nga projekti), si dhe përfaqësuesit e Zyrave Lokale të Komuniteteve (ZLK).

Detyra	Autoriteti përgjegjës
Shpalosja e informatave për të gjithë njerëzit e prekur nga Projekti dhe komunitetet	MI përmes NjZP dhe Komuna e Gjilanit
Vlerësimi i pronës	MF (Zyra për Vlerësimin të Pronës)
Komunikimi direkt dhe vizitat pronarëve/banuesve	MI si përfitues i shpronësimit dhe MMPHI si autoritet shpronësues
Negociatat dhe aktivitetet e shpronësimit, para fillimit të ndërtimit	MMPHI si autoritet shpronësues
Pagesa/ofrimi i pakove të kompensimit	MMPHI
Monitorimi dhe raportimi në lidhje me shpronësimin	MI përmes NjZP
Monitorimi dhe raportimi përkitazi me shfrytëzimin e përkohshëm të tokës kryer pas fillimit të ndërtimit	Kontraktuesi
Menaxhimi i ankimeve	MMPHI përmes NjZP dhe Kontraktuesi

Tabela 10: Përgjegjësitë e zbatimit të PPTRJ-së

Më poshtë janë dhënë hapat e ardhshëm në zbatimin e këtij PPTRJ-je:

1. Shpalosja e PPTRJ-së (dhe informatave tjera relevante të Projektit, siç është përshkruar në Seksionin 6.3.1 të këtij PPTRJ-je) në faqen e internetit të MMPHI-së dhe faqen e internetit të Komunitet të Gjilanit pas miratimit nga BERZH. Ofrimi i kopjeve fizike të PPTRJ-së në ambientet e MMPHI-së dhe të Komunitet të Gjilanit pas kërkesës nga palët e interesuara;
2. Themelimi i Regjistrin të Ankesave dhe shpalosja e Formularit të Ankesave në faqen e internetit të MMPHI-së dhe ofrimi i ndihmës për të gjithë personat e interesuar siç është përshkruar në Kapitullin 8 të këtij PPTRJ-je;
3. Organizimi i takimeve me akterët siç është përshkruar në Seksionet 6.3.2. dhe 6.3.3 të këtij PPTRJ-je dhe takimet individuale konsultative me personat e prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë ashtu siç është përshkruar në Seksionin 6.3.2 të këtij PPTRJ-je.
4. Vlerësimi i pronës, negociatat dhe aktivitetet e shpronësimit në përputhje me legjislacionin kombëtar (nga Organi për Shpronësim) siç përcaktohet në Seksionin 1.3.2. të këtij PPTRJ-je;

²⁴ Zyra për vlerësim të pronës së paluajtshme (në kuadër të Departamentit për tatimin në pronë) përbrenda Ministrisë së Financave, është organi i vetëm publik kompetent për vlerësimin e çdo patundshmërie që do t'i nënshtrohen shpronësimit

- a. MMPHI do të përditësojë dokumentet e shpronësimit të tokës me ndihmën e ekspertëve të jashtëm.
